

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

"BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR"



**Raport tremujor
shkurt 2025**



Përmbajtja

Hyrje	3
I. Lëvizjet makroekonomike.....	6
1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar	6
1.2. Oferta në vend	10
1.3. Kërkesa agregate	14
1.3.1. Konsumi personal.....	15
1.3.2. Konsumi publik	16
1.3.3. Konsumi i investimeve.....	17
1.3.4. Kërkesa neto për eksport.....	17
1.4. Punësimi dhe pagat.....	18
1.5. Inflacioni	21
1.5.1. Inflacioni aktual	21
1.5.2. Pritshmëritë për inflacionin	25
1.6. Bilanci i pagesave.....	26
1.6.1. Llogaria rrjedhëse	27
Shtojca 1: Shkëmbimi i jashtëm tregtar dhe lëvizja e kursit nominal dhe real efektiv të këmbimit (KNEK dhe KREK).....	28
1.6.2. Llogaria financiare.....	31
1.6.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm bruto	33
II. Politika monetare.....	36
2.1. Likuiditeti i bankave.....	39
III. Lëvizjet e tregjeve financiare	40
3.1. Tregu ndërbankar me depozita të pasiguruara	40
3.2. Tregu i letrave shtetërore me vlerë	41
3.3. Bursat.....	44
IV. Agregatët monetarë dhe kreditorë	45
4.1. Agregatë monetarë	45
4.2. Aktiviteti kreditues	48
V. Financat publike.....	52

Hyrje

Në tremujorin e fundit të vitit 2024, Banka Popullore ka vijuar me normalizimin gradual të pozicionimit të politikës monetare, në përputhje me kushtet në ekonomi. Norma e interesit për bonot e thesarit u ul dy herë me 0.25 p.p. dhe e njëjta u pozicionua në nivelin 5.55%. Gjithashtu, ka pasur ulje të njehershme të interesave për depozitat njëditore dhe shtatë ditore në nivelet përkatësisht 3.95% dhe 4%. Me një ndryshim të tillë të normave të interesit ruhet qasja e kujdesshme në drejtimin e politikës monetare, e cila kushtëzohet nga prania e vazhdueshme e rreziqeve që lidhen me mjedisin e jashtëm, por edhe me faktorët e brendshëm që ndikojnë në kërkesën agregate. Një pozicionim i tillë i politikës monetare, gjegjësisht niveli aktual i normave të interesit, së bashku me ndryshimet në rezervën e detyrueshme dhe masat makroprudenciale të ndërmarra deri më tani, kontribuojnë në ruajtjen e mëtejshme të stabilitetit të çmimeve në afat të mesëm dhe në stabilitetin e kursit të denarit ndaj euros. Ndryshimet në politikën e brendshme monetare u ndikuan edhe nga pozicionimi i Bankës Qendrore Evropiane, e cila vazhdoi me normalizimin gradual të politikës monetare në tremujorin e katërt të këtij viti dhe i uli në dy raste normat e interesit, në total me 0.50 p.p.

Ekonomia globale vazhdoi të rimëkëmbet, me inflacion më të ulët dhe kushte më të favorshme financiare. Pas serisë së krizave, rritja globale është stabilizuar dhe në dy vitet e ardhshme pritet ta ndjekë dinamikën aktuale¹, perceptimin si në projeksionet e tetorit. **Rreziqet për rritjen globale në periudhën afatmesme janë kryesisht në rënie, ndërkohë që perspektivat afatshkurtra karakterizohet nga rreziqe të balancuara. Ana negative dominohet nga rritja e pasigurisë gjeopolitike, për shkak të luftërave dhe konflikteve, si dhe sanksionet e mundshme tregtare.** Intensifikimi i mundshëm i tensioneve gjeopolitike mund t'i përkeqësojë tregjet e energjisë dhe zinxhirët e furnizimit, duke e rritur potencialisht inflacionin dhe duke e ulur aktivitetin ekonomik. Tensione të tilla kanë krijuar tashmë një mjedis të pafavorshëm për tregtinë globale, kurse përshkallëzimi i mundshëm i mëtejshëm i fragmentimit të tregtisë dhe fushëveprimit të politikave proteksioniste mund të çojë në përkeqësim shtesë. Veç kësaj, rivlerësimi i mundshëm i rrezikut në tregjet financiare, pra rritja e mundshme e kostove të financimit, mund të krijojë presion shtesë. Në anën pozitive, si rreziqe për rritje më të lartë përmenden avancimi i shpejtë i inteligjencës artificiale, por edhe teknologji të tjera, si automatizimi, energjia e pastër dhe bio-teknologjia, të cilat mund t'i transformojnë sektorët kyç, duke i bërë ata më efikas dhe duke gjeneruar mundësi të reja për zgjerim ekonomik. Si rrezik në rritje është edhe mundësia për rinovimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe lidhjen e marrëveshjeve të reja tregtare nga disa prej ekonomive më me ndikim, gjë që do të rriste konsumin dhe besimin e biznesit.

Treguesit e fundit nga ekonomia vendase flasin për pamje makroekonomike që nuk devijon ndjeshëm nga vlerësimet e tetorit. Përkatësisht, PBB-ja reale në tremujorin e tretë shënoi rritje vjetore prej 3%, afër pritjeve sipas ciklit të projeksionit të tetorit. E analizuar në mënyrë strukturore, rritja rrjedh nga kontributi pozitiv i kërkesës së brendshme, me rritje në të tre komponentët e saj, por mbi të gjitha e konsumit publik, i ndjekur nga konsumi i amvisërive, në kushtet e rritjes së të ardhurave të disponueshme dhe rritjes së qëndrueshme të kreditimit. Nxitësit e jashtëm të rritjes mbeten më pak të favorshëm për shkak të aktivitetit të dobët ekonomik të partnerëve tanë kryesorë tregtarë. Në tremujorin e tretë, eksportet neto patën një kontribut të vogël negativ, në kushtet e stagnimit të dinamikës vjetore të eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve. **Sinjalet nga të dhënat e disponueshme me frekuencë të lartë për aktivitetin ekonomik në tremujorin e fundit të vitit, tani për tani tregojnë për realizime pozitive vjetore, kryesisht në segmentin e shërbimeve dhe në aktivitetin e ndërtimtarisë.** Për të gjithë vitin 2024, skenari bazë nga tetori supozon rritje ekonomike prej 2.3%, por duke i marrë parasysh vlerësimet zyrtare të rritjes së arritur në tre tremujorët e parë të vitit prej 2.6%², ka perspektiva për realizime disi më të mira se sa ishte parashikuar për të gjithë vitin. Rritja pritet të përshpejtohet në 3.3% në vitin 2025 dhe të arrijë në 4% në periudhën afatmesme, mes

¹Sipas raportit të OECD-së "Rishikimi ekonomik", nga dhjetori i vitit 2024, si dhe raporti "Perspektivat ekonomike botërore" i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i publikuar në janar të vitit 2025.

²Këto janë të dhëna të reja të publikuara, të cilat janë rishikuar dhe nuk janë marrë parasysh në projeksionet e tetorit.



pritsmërive për një mjedis të jashtëm më të favorshëm, një mjedis të favorshëm për investimet e huaja dhe vendase dhe një kontribut pozitiv nga projektet infrastrukturore të nisura. **Në afat të shkurtër, rreziqet ndaj rritjes mbeten kryesisht në rënie.** Pasiguria gjeopolitike në rritje për shkak të luftërave dhe konflikteve dominon në afat të shkurtër, me mundësi të shkaktimeve të përkeqësimeve në tregjet e energjisë dhe në tregjet e produkteve ushqimore primare. Në planin afatmesëm, fokusimi më i fuqishëm në investimet kapitale, përfshirë planin e ri të Bashkimit Evropian për rritje në Ballkanin Perëndimor, pritët ta forcojë integrimin ekonomik, gjë që do t'i përmirësonte perspektivat ekonomike të vendit. Në të njëjtën kohë, anëtarësimi i pritshëm në Zonën e vetme të pagesave në euro (SEPA) do ta forconte integrimin e tregut të vendit me vendet anëtare të BE-së, gjë që do të rezultojë në uljen e kostove të transaksioneve dhe përmirësimin e efikasitetit në tregtinë ndërkufitare me BE-në.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, norma vjetore e inflacionit ashtu siç pritej u përshpejtua dhe arriti në 4.1%. Përshpejtimi lidhet thuajse tërësisht me komponentin ushqimor të inflacionit, kryesisht për shkak të efekteve bazë që rezultojnë nga masa të ndryshme të përkohshme për uljen dhe ngrirjen e çmimeve të disa produkteve ushqimore në tregtinë e brendshme me pakicë në të njëjtën periudhë të vitit 2023. Dinamika vjetore e komponentit bazë në tremujorin e fundit është përgjithësisht e qëndrueshme, ndërkohë që komponenti energjetik ka shënuar një thellim të normës vjetore të rënies. **Inflacioni për të gjithë vitin 2024 mesatarisht është 3.5%, që përputhet plotësisht me vëzhgimet e tetorit.** Sipas vlerësimeve të tetorit, në vitin 2025 inflacioni pritët të ulët në 2.5% dhe gradualisht të normalizohet në 2% në periudhë afatmesme. Rreziqet rreth inflacionit ekzistojnë ende dhe lidhen kryesisht me çmimet e produkteve parësore në bursat botërore. Përkatesisht, ngjarjet ekstreme klimatike dhe moti, rritja e pasigurisë gjeopolitike dhe fragmentimi i tregtisë potencialisht mund ta përkeqësojnë ekuilibrin midis ofertës dhe kërkesës globale dhe të ndikojnë mbi çmimet.

Të dhënat e fundit të disponueshme për bilancin e pagesave tregojnë se flukset e realizuara në llogarinë rrjedhëse dhe financiare janë në përputhje me pritjet sipas projeksionit të tetorit. Në tremujorin e tretë, transaksionet rrjedhëse shënuan suficit prej 1.8% të PBB-së, që paraqet përmirësim me bazë vjetore, i cili i detyrohet tërësisht suficitit më të lartë në shkëmbimin e shërbimeve me vendet e huaja. Arritjet më të mira të shërbimeve janë kryesisht rezultat i deficitit më të ulët në shërbimet e ndërtimitarisë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur janë realizuar flukse dalëse më të mëdha lidhur me ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d, si dhe një kontribut shtesë ka edhe suficit më i lartë në udhëtime. Për sa u përket komponentëve të mbetur të llogarisë rrjedhëse, të ardhurat dytësore shënuan suficit më të ulët, ndërsa deficitin në të ardhurat primare u rrit lehtë në bazë vjetore. Në llogarinë financiare, gjatë tremujorit të tretë, janë realizuar dalje neto prej 1.9% të PBB-së, si rezultat i daljeve neto në shumicën e kategorive, të cilat janë neutralizuar në masë të madhe nga flukse neto të mëtejshme të qëndrueshme nga investimet e drejtpërdrejta. **Të dhënat për rezervat valutore bruto për tremujorin e katërt tregojnë për realizime më të mira krahasuar me projeksionet e tetorit dhe për rrjedhojë rritje më të lartë për të gjithë vitin. Niveli i rezervave valutore në fund të vitit 2024 arriti në 5,019 milionë euro dhe, sipas të gjithë treguesve, siguron mbështetje adekuatë për ruajtjen e stabilitetit të monedhës vendase.**

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, aktiviteti kreditues i sektorit bankar është forcuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm, trend ky karakteristik për tregun e kredisë në fund të vitit. U përshpejtua edhe norma vjetore e rritjes e totalit të kredisë, e cila në fund të këtij tremujori shënoi vlerën 11.2%, më e fuqishme se pritjet sipas projeksionit të tetorit (7.5%). Aktiviteti kreditues është mbështetur edhe nga rritja e burimeve të financimit. Konkretisht, **në tremujorin e fundit, u shënuar rritje e përforcuar tremujore edhe në bazën e depozitave, e cila solli përshpejtim të mëtejshëm të rritjes vjetore të depozitave,** e cila arriti në 11.4%, që është mbi pritjet për fundin e vitit sipas projeksionit të tetorit (7.9%). Njëkohësisht, vazhdojnë të shënohen zhvillime të favorshme në aspektin e maturitetit dhe strukturës valutore të kursimeve (rritje e depozitave në denarë dhe depozitave afatgjata), duke i reflektuar efektet e masave të ndërmarra nga Banka Popullore dhe pritjet e stabilizuara të subjekteve ekonomike.



Në përgjithësi, treguesit makroekonomikë tregojnë se arritjet në segmentet kryesore të ekonomisë janë përgjithësisht në përputhje me pritjet. Inflacioni i brendshëm, siç pritej, u përshpejtua në tremujorin e fundit i ndikuar kryesisht nga efektet bazë në komponentin ushqimor, ndërkohë që arritjet për të gjithë vitin janë në linjë me projeksionin. Aktiviteti i brendshëm ekonomik po përshpejtohet mesatarisht, në përputhje me pritjet nga parashikimet e fundit për rritje më të fuqishme ekonomike në vitin 2024. Vazhdon mbështetja kreditore e ekonomisë vendase nga bankat, me dinamikë rritjeje më të fuqishme se sa pritej, me rritje më të fuqishme edhe të bazës së depozitave. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë edhe më tej mbetet i favorshëm dhe mundëson rritjen e rezervave valutore, të cilat vazhdojnë të ruhen në zonën e sigurt. *Megjithatë, mjedisi ekonomik mbetet i pasigurt dhe rreziqet për ekonominë globale dhe të brendshme ende ekzistojnë. Është i domosdoshëm monitorim i mëtejshëm dhe kujdes më i madh për politikat që ndikojnë mbi kërkesën në ekonominë vendase, jo vetëm nga këndvështrimi i tregut të punës, por edhe në përgjithësi nga këndvështrimi i rrugës së konsolidimit fiskal të parashikuar në periudhë afatmesme. Banka Popullore, si edhe më parë, vazhdon t'i monitorojë nga afër të dhënat dhe rreziqet makroekonomike dhe do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme duke i përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, për ta ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit dhe stabilitetin e çmimeve.*


I. Lëvizjet makroekonomike

1.1. Mjedisi ekonomik ndërkombëtar


Ekonomia globale vazhdoi të rritet në tremujorin e tretë të vitit 2024, në kushtet e ngadalësimit të mëtejshëm të inflacionit dhe kushteve më të relaksuara financiare. Megjithatë, aktiviteti global vazhdon të zhvillohet në kushtet e pasigurisë së lartë ekonomike dhe tensioneve të theksuara gjeopolitike. Në eurozonë, e cila është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, aktiviteti ekonomik arriti rritje vjetore të vogël por të përshpejtuar në tremujorin e tretë të vitit 2024. Megjithatë, performanca ekonomike e eurozonës ka qenë më e dobët se ajo e ekonomive të tjera të zhvilluara, e ndikuar kryesisht nga sektorët e prodhimit dhe eksportit të ekonomisë gjermane. Procesi i dezinflacionit në nivel global vazhdon, ndonëse në vende të caktuara me ritme më të ngadalta. Sido që të jetë, këto arritje u mundësuar disa vendeve të zhvilluara të vijnë me normalizimin gradual të politikës monetare, nëpërmjet uljes së kujdesshme të normave të interesit. Në bursat botërore, tremujori i katërt i vitit 2024 ka shënuar rënie të çmimeve të naftës, ndërsa indeksi i çmimeve të produkteve joenergjetike është rritur në krahasim me tremujorin e mëparshëm. Në përputhje me projeksionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar nga janari i vitit 2025, rritja ekonomike botërore nga 3.2% në vitin 2024, do të përshpejtohet lehtësisht dhe do të qëndrojë në 3.3% në vitet 2025 dhe 2026 (por ende nën mesataren historike), në kushtet e ngadalësimit të inflacionit dhe kushteve më të favorshme financiare. Kështu, krahasuar me projeksionet e tetorit, vlerësimi është përgjithësisht i pandryshuar kryesisht për shkak të rishikimit në rritje në SHBA, i cili i kompenson rishikimet në rënie në ekonomitë e tjera kryesore. Inflacioni global do të vazhdojë prirjen rënëse, ku vendet më të zhvilluara do ta arrijnë nivelin e synuar pak më shpejt se sa pritej më parë.

Aktiviteti ekonomik global vazhdoi të rritet në mënyrë të qëndrueshme në tremujorin e tretë të vitit 2024³, i nxitur nga ngadalësimi i inflacionit dhe lehtësimi gradual i kushteve monetare, por mes tensioneve dhe paqëndrueshmërisë të vazhdueshme gjeopolitike. Brenda vendeve të zhvilluara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe më tej vazhdojnë ta kenë rritjen më të lartë, me 2.7%, por ajo po ngadalësohet lehtë (3.0% në tremujorin e mëparshëm), e ndikuar nga zhvillimet më pak të favorshme në investimet bruto dhe eksportet neto. Në Mbretërinë e Bashkuar, rritja u përshpejtua në 0.9% (kundrejt 0.7% në tremujorin e dytë), kryesisht si rezultat i rritjes më të fuqishme të konsumit personal dhe zhvillime të ngjashme u vunë re në zonën e euros (rritje prej 0.9%, kundrejt 0.6% në tremujorin e dytë), kryesisht për shkak të arritjeve më të mira, përkatësisht, një rënie dukshëm më e dobët e investimeve-bruto. Japonia, pas rënies që nga fillimi i vitit, shënoi rritje në tremujorin e tretë prej 0.5% për herë të parë (rënie prej 0.9% në tremujorin e mëparshëm), për shkak të realizimeve më të mira të kërkesës së brendshme. Rritje e aktivitetit ekonomik është vërejtur edhe në vendet nga grupi i ekonomive **me rritje të shpejtë**. Rritja në Kinë është stabilizuar në 4.6% (4.7% në tremujorin e dytë), në kushte të konsumit të qëndrueshëm por të dobët dhe problemeve të vazhdueshme në sektorin e pasurive të paluajtshme. Rritja e ekonomisë indiane vazhdon të ngadalësohet mesatarisht dhe ra në 5.8% (6.6% në tremujorin e mëparshëm), e ndikuar nga realizimet më të dobëta të konsumit personal dhe e investimeve bruto. Ndryshe nga ekonomitë e sipërpërmendura, rritja e aktivitetit ekonomik në Brazil vazhdoi të përshpejtohej në tremujorin e tretë të vitit 2024 dhe arriti në 3.5% (2.8% në tremujorin e mëparshëm), për shkak të realizimeve më të mira të kërkesës së brendshme.

³Në këtë seksion analizohen të dhënat e PBB-së që janë të përshtatura në mënyrë sezonale dhe kalendarike.



Ne raport me vlerësimet për rritjen globale në tremujorin e fundit të vitit 2024, vlera mesatare e indeksit global PMI është e qëndrueshme në 52.4, e njëjtë me tremujorin e tretë, e ndikuar nga lëvizjet e qëndrueshme, por pak më të dobëta në sektorin e shërbimeve, me një farë përmirësimi në sektorin e prodhimit. Në bazë vjetore, indeksi global PMI shënoi rritje prej 3.8%.





Rritja ekonomike globale⁴ do të përshpejtohet pak, nga 3.2% në vitin 2024, në 3.3% në vitet 2025 dhe 2026, në kushte të presioneve në rënie të inflacionit dhe kushteve më të favorshme financiare globale. Kështu, krahasuar me projeksionet e tetorit, pritjet e rritjes për vitin 2025 janë rishikuar paksa në rritje me 0.1 pikë përqindjeje, ndërsa për vitet 2024 dhe 2026 ato janë të pandryshuara. Inflacioni⁵ do të vazhdojë të bjerë, pak më shpejt se sa pritej më parë, duke rënë në 4.2% dhe 3.5% përkatësisht në vitet 2025 dhe 2026, në kushtet e presioneve në rënie në tregun e punës dhe rënies së çmimeve të energjisë. Rreziqet për rritjen e parashikuar ekonomike globale në periudhën afatmesme janë kryesisht në kahun rënës, ndërkohë që perspektivat afatshkurtra karakterizohen nga rreziqe të balancuara. Rreziqet negative lidhen me intensifikimin e politikave proteksioniste, të cilat mund t'i përkeqësojnë tensionet tregtare, t'i zvogëlojnë investimet, ta zvogëlojnë efikasitetin e tregut dhe t'i prishin përsëri zinxhirët e furnizimit. Përveç kësaj, mund të intensifikohen tensionet gjeopolitike, duke çuar në përkeqësimin e mëtejshme të flukseve tregtare dhe rritje të çmimeve të produkteve primare. Nga ana tjetër, ekzistojnë edhe rreziqe pozitive që lidhen me rinovimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe

⁴ Analiza në këtë seksion bazohet në raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar "Perspektivat ekonomike botërore", të botuar në janar të vitit 2025.

⁵Projeksioni për inflacionin në raport me parashikimet e tetorit është me 0.1 pikë përqindje më i ulët dhe për vitet 2025 dhe 2026.

lidhjen e marrëveshjeve të reja tregtare nga disa prej ekonomive me ndikim në botë, të cilat mund të kontribuojnë në rritjen e besimit të konsumatorëve, lehtësimin e pasigurisë dhe rritjen e investimeve.

Inflacioni në nivel global vazhdoi të ngadalësohej në tremujorin e katërt, megjithëse në një numër të vogël vendesh të zhvilluara, në përputhje me pritshmëritë, ai u përshpejtua për shkak të bazës së ulët të krahasimit të çmimeve të lëndëve djegëse dhe presioneve të lehta në rritje nga çmimet e ushqimeve. Kështu, inflacioni në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA u rrit në tremujorin e katërt dhe shënoi përkatësisht 3.4% dhe 2.7% (përkatësisht 2.9% dhe 2.6% në tremujorin e mëparshëm). Inflacioni mesatar në eurozonë ngeci në tremujorin e katërt dhe arriti në 2.2% (i njëjtë me tremujorin e tretë), nën ndikimin e presioneve të ulura të çmimeve nga inflacioni bazë. Inflacioni në Japoni u ngadalësua në dy muajt e parë të tremujorit të katërt dhe është 2.6% (2.8% në tremujorin e tretë).



Në eurozonë, e cila është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, aktiviteti ekonomik në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi rritje të lehtë vjetore prej 0,9% (rritje prej 0,6% në tremujorin e mëparshëm). Në të njëjtën kohë, përshpejtimi i rritjes është kryesisht rezultat i rënies dukshëm më të dobët të investimeve bruto dhe në një masë të vogël edhe i kontributit më pozitiv të konsumit publik. Rritja e pasigurisë⁶ së konsumatorit po kontribuon në rritje më të ulët se sa pritej, gjë që ka çuar në rishikime në rënie për vitet 2024, 2025 dhe 2026 në parashikimet e dhjetorit të BQE-së. Kështu, për vitin 2024, rritja ekonomike në eurozonë pritet të jetë 0.7%, dhe përshpejtimi gradual i saj në 1.1% dhe 1.4% përkatësisht në vitet 2025 dhe 2026⁷. Për vitin 2027, rritja pritet të stabilizohet në 1.3%. Lëvizjet në tregun e punës në eurozonë janë përgjithësisht të qëndrueshme, duke pasur parasysh se shkalla e papunësisë në dy muajt e parë të tremujorit të katërt është e njëjtë me tremujorin e mëparshëm, në nivelin më të ulët historik prej 6.3%.

Norma vjetore e inflacionit në eurozonë në tremujorin e katërt të vitit 2024 ishte mesatarisht 2.2%, e njëjtë me atë të arritur në tremujorin e tretë. Me projeksionet e fundit të dhjetorit të BQE-së, të ndikuar nga reduktimi i pritshëm i vazhdueshëm i presioneve të çmimeve të energjisë, është bërë një rishikim i lehtë në rënie i normës së inflacionit të pritshëm për vitet 2024 dhe 2025, e cila do të ishte përkatësisht në 2.4% dhe 2.1%, ndërsa për vitin 2026 vlerësimi është i pandryshuar (1.9%)⁸. Për vitin 2027 parashikohet një rritje e çmimeve prej 2.1%.



Në tremujorin e katërt të vitit 2024, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara vazhduan ta normalizojnë gradualisht politikën monetare, në kushte të ngadalësimit të normës së inflacionit dhe perspektivave për uljen e inflacionit në periudhën afatmesme në nivelin e pritshëm. BQE-ja, në tetor dhe dhjetor të vitit 2024, i uli më tej normat e interesit për depozitat e disponueshme, kreditë e disponueshme njëditore dhe për operacionet bazë të rifinancimit me nga 0.25 p.p. (gjithsej me

⁶Sipas treguesve për besimin e biznesit dhe besimin e konsumatorëve të matur nga Komisioni Evropian.

⁷Sipas projeksionit të shtatorit të vitit 2024, rritja e parashikuar e aktivitetit ekonomik ishte 0.8% në vitin 2024, 1.3% në vitin 2025 dhe 1.5% në vitin 2026.

⁸Sipas projeksionit të shtatorit të vitit 2024, norma e inflacionit ishte 2.5% në vitin 2024, 2.2% në vitin 2025 dhe 1.9% në vitin 2026.

0,5 p.p.). Për rrjedhojë, norma e interesit për depozitat e disponueshme, për operacionet bazë të rfinansimit dhe për kreditë e disponueshme njëditore u vendosën përkatësisht në 3.0%, 3.15% dhe 3.40%. Ashtu si më parë, portofoli i Programit të blerjes së letrave me vlerë (APP) vazhdon të bjerë gradualisht dhe me ritëm të parashikueshëm, pasi letrat me vlerë që maturohen nuk riinvestohen më, kurse portofoli në kuadër të Programit të blerjes së letrave me vlerë për mbështetje emergjente për ekonominë për shkak të pandemisë (PEPP) do të bjerë me një mesatare prej 7.5 miliardë euro në muaj, deri në ndërprerjen të plotë të riinvestimeve sipas këtij programi në fund të vitit 2024. Pas uljes fillestare në shtator, FED-ja në nëntor dhe dhjetor e uli dy herë normën bazë të interesit, me një total prej 0.5 p.p. dhe e zvogëloi atë në një interval prej 4,25% në 4,50%, në kushtet e rritjes së qëndrueshme të aktivitetit ekonomik, presioneve të reduktuara nga rritja e pagave dhe punësimit dhe inflacionit më të ulët që po ecën ngadalë drejt objektivit. Përveç kësaj, FED-ja do të vazhdojë ta reduktojë më tej portofolin e saj të letrave me vlerë të thesarit dhe hipotekave, siç ka bërë deri më tani. Banka e Anglisë gjithashtu e uli më tej normën e interesit referencë me 0.25 p.p. në nëntor, me 4.75%. Banka e Japonisë e mbajti të pandryshuar normën e saj bazë të interesit në 0.25% në tremujorin e katërt të vitit 2024, në kushte të rimëkëmbjes së pritshme ekonomike, kushteve të favorshme financiare dhe përmirësimit të papunësisë.



Në tremujorin e katërt të vitit 2024, vlera e dollarit amerikan kundrejt euros u rrit me 3,0% krahasuar me tremujorin e mëparshëm, si rezultat i vlerësimeve të tregut për ulje më të ngadaltë dhe më të përmbajtur të normave të interesit nga FED-ja, në përputhje me njoftimet për ndryshime në politikën e tregtisë së jashtme pas zgjedhjeve presidenciale. E parë në bazë vjetore, dollari amerikan ka ngritje të vlerës me 0.8%, duke arritur mesatarisht në 0.94 euro gjatë kësaj periudhe.

Çmimet e produkteve primare në bursat botërore, të shprehura në euro, janë rritur në tremujorin e katërt të vitit 2024, me përjashtim të çmimit të naftës. Kështu, çmimi mesatar i naftës në këtë periudhë është 69.4 euro për fuçi dhe është më i ulët për 3.2% krahasuar me tremujorin e mëparshëm, përkatësisht me 10.1% në bazë vjetore. Lëvizja në rënie e çmimeve të naftës rrjedh nga ulja e kërkesës globale dhe rritja e prodhimit jashtë OPEC+, pavarësisht vendimit të OPEC+ për ta filluar rritjen e prodhimit më vonë⁹. Përkundrejt kësaj, indeksi i çmimeve të produkteve primare¹⁰ joenergjetike shënoi rritje prej 6.8% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024. E parë sipas grupeve të produkteve, indeksi i ushqimeve dhe indeksi i çmimeve të metaleve bazë¹¹ shënuan rritje përkatësisht me 5.7% dhe 5.6%.¹²

⁹Me vendim të OPEC+ në mbledhjen e 5 dhjetorit, shtyhet nisja e rritjes së prodhimit të naftës me tre muaj deri në prill të vitit 2025.


¹⁰Ky indeks agregat e përfshin indeksin e metaleve të çmuara, indeksin e ushqimeve dhe pijeve, indeksin e lëndëve të para bujqësore dhe indeksin e metaleve bazë.

¹¹Në këtë indeks përfshihen produktet e mëposhtme ushqimore primare: drithërat, vaji vegjetal, mishi, prodhimet e detit, sheqeri dhe ushqime të tjera.

¹²Në këtë indeks përfshihen metalet e mëposhtme: alumini, kobalti, bakri, hekuri, plumbi, molibdeni, nikeli, kallaji, uranumi dhe zinku.




Burimi: FMN dhe vlerësimet e BPRMV-së.




Burimi: FMN dhe vlerësimet e BPRMV-së

Për sa i përket vendeve të rajonit, rritje pak më e fuqishme është shënuar në Bullgari dhe Shqipëri, e nxitur nga konsumi publik dhe në Kroaci e ndikuar nga eksporti neto. Në anën tjetër, në Serbi vërehet dinamikë më e ngadaltë e rritjes, kryesisht për shkak të përkeqësimit të eksportit neto, ndërsa rritja në Kosovë është e ngjashme me atë të tremujorit të mëparshëm. Në Rumani, ka rënie për herë të parë në katër vjet, e ndikuar nga përkeqësimi i kërkesës së brendshme. Për sa i përket **inflacionit në vendet e rajonit, tremujori i katërt i vitit 2024** në përgjithësi ka pasur ose ngecje ose rritje të lehtë, të ndikuar kryesisht nga presionet e rritura të çmimeve të ushqimeve (përjashtim bën Kosova, ku inflacioni po ngadalësohet).



Burimi: Eurostat dhe Agjencioni i Statistikës së Kosovës.



Burimi: Eurostat dhe entetnacionale të statistikës.

1.2. Oferta në vend

Aktiviteti në ekonominë vendase shënoi rritje të qëndrueshme në tremujorin e tretë të vitit 2024 me normë reale vjetore prej 3%, që paraqet një përshpejtim të lehtë krahasuar me rritjen e tremujorit të mëparshëm (2.8%). Rritja në masë të madhe ka ardhur si pasojë e kontributit pozitiv të grupit të veprimtarive "tregti, transport dhe hotelieri", ndërsa ndikim pozitiv kanë pasur edhe veprimtaritë e tjera të shërbimit, si dhe aktiviteti ndërtimor. Gjithashtu, rritje reale shënoi edhe bujqësia, pavarësisht rënies në tremujorët e mëparshëm. Megjithatë, realizimet në një nga sektorët kryesorë – industri, edhe këtë tremujor, kanë mbetur në zonën negative, që është kryesisht për shkak të prirjeve të pafavorshme në aktivitetet tradicionale. Në bazë tremujore, PBB-ja shënon rritje reale prej 0.6%. Të dhënat me frekuencë të lartë në anën e ofertës, të cilat janë të disponueshme për periudhën



tetor-nëntor kryesisht tregojnë për rritje të mëtejshme të aktivitetit ekonomik. Vlerësimet e drejtuesve për gjendjen e biznesit të ndërmarrjeve për tremujorin e katërt të vitit 2024 janë më të favorshme në tregti, industri dhe shërbime, ndërsa në ndërtimtarin janë disi më pak të favorshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për periudhën e ardhshme, drejtuesit e kompanive kanë pritshmëri më të favorshme.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, rritja reale vjetore e PBB-së është 3% (ritje prej 2,8% në tremujorin e mëparshëm)¹³, me rritje tremujore prej 0,6% (e përshtatur në mënyrë sezonale dhe kalendarike). E parë nga ana e prodhimit të PBB-së, pjesa më e madhe e veprimtarive shënuan rritje, por rritja ekonomike në masën më të madhe i detyrohet kontributit pozitiv të grupit të veprimtarive "tregti, transport dhe hotelieri". Nga ana tjetër, në industri vërehet sërish kontribut negativ.

PBB-ja dhe komponentët - normat vjetore të rritjes (në %)

	normat e rritjes vjetore, në %*							
	2020	2021	2022	2023	Tr.1 2024	Tr.2 2024	Tr.3 2024	Tr.1-Tr.3 2024
Bujqësia	2.5	-8.7	-6.4	-3.0	-12.3	-0.7	1.1	-4.0
Industria	-6.7	2.2	-4.6	1.4	0.6	-1.3	-4.6	-1.8
Industria përpunuese	-4.8	6.1	-3.7	1.5	1.1	1.5	-2.9	-0.1
Ndërtimi	-4.0	-6.0	7.5	-0.4	-2.4	6.9	2.4	2.3
Tregtia, transporti dhe veprimtaria hotelierike	-10.6	7.6	2.3	3.2	4.2	5.5	10.6	6.8
Informacioni dhe komunikacioni	4.5	12.2	17.7	5.8	4.2	3.7	2.4	3.4
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-0.1	-0.1	-0.9	6.1	1.8	1.9	2.1	1.9
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	1.1	7.0	19.7	8.0	2.5	1.7	0.5	1.6
Shërbime administrative dhe mbështetëse	-8.7	14.5	13.1	1.7	8.5	9.9	9.0	9.1
Administrim publik	3.2	4.0	-4.9	-0.8	2.0	0.6	0.9	1.2
Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitetet të tjera shërbimi	-22.6	17.2	7.1	3.4	12.5	4.1	6.6	7.8
Prodhimi i brendshëm bruto	-4.7	4.5	2.8	2.1	1.9	2.8	3.0	2.6

*Nga publikimi i PBB-së me datë 06.12.2024

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.

PBB-ja dhe komponentët - kontributet në rritjen e PBB-së (në p.p.)

	kontributet në rritjen e PBB-së, në p.p.							
	2020	2021	2022	2023	Tr.1 2024	Tr.2 2024	Tr.3 2024	Tr.1-Tr.3 2024
Bujqësia	0.2	-0.7	-0.5	-0.2	-0.6	0.0	0.0	-0.2
Industria	-1.2	0.4	-0.8	0.2	0.1	-0.2	-0.8	-0.3
Industria përpunuese	-0.6	0.8	-0.5	0.2	0.1	0.2	-0.4	0.0
Ndërtimi	-0.2	-0.3	0.4	0.0	-0.2	0.3	0.2	0.1
Tregtia, transporti dhe veprimtaria hotelierike	-2.1	1.5	0.5	0.6	0.8	1.1	2.0	1.3
Informacioni dhe komunikacioni	0.2	0.5	0.7	0.3	0.2	0.2	0.1	0.2
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.1	0.1	0.0
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	0.1	0.7	2.0	0.9	0.3	0.2	0.0	0.2
Shërbime administrative dhe mbështetëse	-0.3	0.5	0.5	0.1	0.5	0.5	0.4	0.5
Administrim publik	0.4	0.5	-0.6	-0.1	0.3	0.1	0.1	0.2
Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitetet të tjera shërbimi	-0.7	0.5	0.2	0.1	0.4	0.1	0.2	0.2
Prodhimi i brendshëm bruto	-4.7	4.5	2.8	2.1	1.9	2.8	3.0	2.6

*Nga publikimi i PBB-së me datë 06.12.2024

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.


Burimi: Llogaritjet e BPRMV-së.

Analizuar nëpërmjet të dhënave me frekuencë të lartë, në tremujorin e tretë të vitit, qarkullimi i përgjithshëm tregtar ka shënuar rritje reale vjetore, në kushtet e rritjes së tregtisë me pakicë dhe shumicë, ndërsa tregtia e automjeteve ka shënuar rënie reale vjetore. Në periudhën tetor-nëntor, tregtia ka shënuar rritje të vogël, më të moderuar në krahasim me tremujorin e mëparshëm, me


¹³Rritja e rishikuar në rritje për tremujorin e dytë, nga 2.3% në 2.8%, nga njoftimi i datës 06.12.2024.



rritje në tregtinë me shumicë dhe tregtinë e automjeteve, ndërsa tregtia me pakicë ka shënuar rënie. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin "tregti me pakicë" për situatën e biznesit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, si dhe pritshmëritë për periudhën në vijim, janë më të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë.




Burimi: Enti Shtetëror Statistikor.




Burimi: Anketa e KE-së për tregtinë me pakicë, Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.

Për sa i përket **transportit**, në tremujorin e tretë të vitit 2024, lëvizjet janë në drejtime të ndryshme, kështu që transporti rrugor dhe hekurudhor i pasagjerëve, si dhe ai i mallrave dhe transporti ajror, shënuan rritje reale vjetore, ndërkohë që ka rënie reale vjetore në trafikun hekurudhor të mallrave dhe në trafikun ajror të pasagjerëve.




Burimi: Enti Shtetëror Statistikor.




Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe Anketa e KE-së për industrinë.

Në **sektorin e hotelierisë**, në tremujorin e tretë të vitit 2024, numri i turistëve dhe numri i bujtjeve vazhduan të shënojnë rritje reale në bazë vjetore, por me ritme më të ngadalta, por dhe qarkullimi total në sektorin e hotelierisë ka shënuar rritje. Të dhënat për tetorin e vitit 2024 tregojnë rritje të shpejtë të numrit të turistëve dhe bujtjeve, por rritet edhe qarkullimi i përgjithshëm në hotelieri. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e shërbimeve për gjendjen e tyre të biznesit në tremujorin e katërt të vitit 2024 janë pak më të favorshme krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, si dhe pritjet për periudhën në vijim për sa i përket kërkesës janë gjithashtu më të favorshme.




Në tremujorin e tretë të vitit 2024, prodhimi industrial¹⁴ shënoi rënie prej 2.1% në bazë vjetore, që është një rënie më e moderuar krahasuar me atë të tremujorit të mëparshëm (prej 7.1%). Rënia erdhi si pasojë e kontributeve negative nga industria përpunuese, sektori i energjisë dhe minierat. Shikuar sipas veprimtarive, në industrinë përpunuese, kontributin më të madh negativ e ka prodhimi i veshjeve, prodhimi i produkteve të tjera minerale jometalike dhe prodhimi i metaleve. Nga ana tjetër, kontributin më të rëndësishëm pozitiv e ka prodhimi i produkteve ushqimore, prodhimi i pajisjeve elektrike dhe prodhimi i automjeteve. Në periudhën tetor-nëntor është vërejtur rënie e prodhimit industrial, me kontribute negative nga sektori i energjisë dhe minierave, ndërsa industria përpunuese ka pasur kontribut të vogël pozitiv. Drejtuesit e sektorit industrial kanë vlerësime më të favorshme për situatën e biznesit në tremujorin e katërt të vitit 2024 krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa pritet janë më të favorshme edhe në aspektin e lëvizjeve të prodhimit në periudhën e ardhshme.



Sipas të dhënave të disponueshme me frekuencë të lartë, **në tremujorin e tretë të vitit 2024, aktiviteti në sektorin e ndërtimit shënoi rritje reale më të ngadaltë, por gjithsesi**

¹⁴ Analiza e lëvizjeve në industri është bërë në bazë të të dhënave mujore për indeksat e prodhimit industrial të ESHS-së.

relativisht të lartë në bazë vjetore. Kështu, rritja në totalin e punimeve të ndërtimtarisë është kryesisht për shkak të rritjes së ndërtimeve të ulëta, si dhe të ndërtimeve të larta, por kontribut minimal pozitiv kanë edhe punimet e specializuara në ndërtimtari.¹⁵ Në tetor, ndërtimtaria shënoi rritje të mëtijshme reale vjetore, me rritje në ndërtimet e ulëta dhe ndërtimet e larta, ndërsa punimet e specializuara në ndërtimtari shënuan rënie. Vlerësimet e drejtuesve të ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimtarisë për zhvillimin e aktivitetit të tyre në tremujorin e katërt të vitit 2024 janë disi më pak të favorshme krahasuar me bazën vjetore, ndërsa pritet për periudhën në vijim janë pak më të favorshme.




1.3. Kërkesa agregate

Nga aspekti i kërkesës, rritja reale vjetore e PBB-së prej 3% në tremujorin e tretë të vitit 2024 rrjedh tërësisht nga kontributi pozitiv i kërkesës së brendshme, ku kontributin më të madh e ka konsumi i qeverisë dhe i amvisërive, ndërsa rritje të vogël shënuan edhe investimet bruto. Kështu, rritja e konsumit publik rezulton nga rritja e kategorive kryesore të tij, shpenzimet për mallra dhe shërbime, transfertat në Fondin e Shëndetësisë dhe shpenzimet e pagave, si dhe nga rritja e konsumit personal nga të ardhurat e disponueshme dhe kreditimi i popullsisë nga bankat. Rritja e investimeve bruto vjen nga rritja e investimeve në mjete bazë, gjë e cila konfirmohet edhe nga lëvizjet e favorshme të kategorive treguese, ndërkohë që rënie është vërejtur në ndryshimin e stokeve. Nga ana tjetër, në këtë tremujor eksportet neto kanë një kontribut të vogël negativ në rritjen e PBB-së.


Analiza strukturore e PBB-së¹⁶ nga këndvështrimi i kërkesës tregon se në tremujorin e tretë të vitit 2024, rritja rrjedh tërësisht nga kontributi pozitiv i kërkesës së brendshme, në kushtet e rritjes në të gjithë komponentët e saj, ndërkohë që eksportet neto kanë kontribut negativ. E parë nga aspekti i komponentëve të veçantë, rritja e kërkesës së brendshme është mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit publik dhe atij personal, i cili u përshpejtua, ndërkohë që pas rënies në tremujorin e mëparshëm, rritje të vogël shënuan edhe investimet bruto. Nga ana tjetër, eksportet neto patën kontribut të vogël negativ, në kushtet e ngecjes së rritjes së eksporteve dhe importeve.

¹⁵Punimet e specializuara në ndërtimtari janë një kategori e re, të cilën ESHS-ja filloi ta publikojë në maj të vitit 2024 në kuadër të të dhënave për punimet e përfunduara në ndërtimtari dhe i përfshin kategoritë "prishje dhe përgatitje të kantierit", "instalime elektrike, hidraulike dhe kanalizime dhe punime të tjera instalimesh ndërtimore", "punime mbarimi në ndërtimtari" dhe "punime të tjera të specializuara ndërtimi".

¹⁶Ndryshimet tremujore në PBB dhe të përbërësve të tij janë llogaritur nga të dhënat e ESHS-së të përshtatura në mënyrë sezonale dhe kalendarike.



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.

	Normat e rritjes reale vjetore (në%)							Kontributet në rritjen reale vjetore (në p.p.)**						
	2021	2022	2023	Tr.1-Tr.3 2024	2024-Tr.1	2024-Tr.2	2024-Tr.3	2021	2022	2023	Tr.1-Tr.3 2024	2024-Tr.1	2024-Tr.2	2024-Tr.3
Konsumi privat	8.6	5.5	1.2	1.6	1.1	1.6	1.9	5.7	3.7	0.8	1.1	0.8	1.1	1.3
Konsumi publik	0.9	-4.3	-1.8	10.0	7.8	9.0	13.3	0.1	-0.7	-0.3	1.5	1.2	1.3	1.9
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	14.3	10.6	-0.6	-3.0	-6.7	-2.5	0.0	8.2	6.9	-0.5	-2.3	-5.1	-1.7	0.0
Importi i mallrave dhe shërbimeve	14.8	13.6	-5.8	-1.4	0.2	-4.1	0.0	-10.4	-11.1	5.4	1.2	0.0	3.7	-0.2
Investimet bruto	2.9	12.0	-9.9	1.2	10.6	-5.7	0.6	0.9	3.9	-3.5	0.7	2.9	-1.3	0.4
Kërkesa e brendshme	6.1	6.0	-2.1	2.4	3.9	0.8	2.8	6.7	6.9	-2.9	3.2	4.9	1.2	3.6
Eksporti neto*	16.3	22.1	-19.1	4.2	26.7	-8.6	0.1	-2.2	-4.1	5.0	-1.1	-5.1	2.0	-0.3
Mospërputhje statistikore								0.0	-0.1	0.0	0.5	2.1	-0.3	-0.4
PBB	4.5	2.8	2.1	2.6	1.9	2.8	3.0	4.5	2.8	2.0	2.6	1.9	2.8	3.0

* Ulja e eksportit neto tregon ngushtim të deficitit.

** Kontributet e komponentëve nuk japin totalin e PBB-së, për shkak të mospërputhjes statistikore në vlerat reale.

Me qëllim të përshtatjes me normat zyrtare të rritjes reale, në totalin e PBB-së është përfshirë mospërputhje statistikore.

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.

1.3.1. Konsumi personal

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, konsumi personal është një nga nxitësit kryesorë të rritjes së kërkesës së brendshme, me rritje vjetore prej 1.9% (rritje tremujore prej 0.7%).

Rritja e konsumit është mbështetur nga rritja e të ardhurave të disponueshme reale, e cila u përshpejtua, në kushtet e një rënie reale dukshëm më të vogël të transfertave private krahasuar me tremujorin e mëparshëm, si dhe rritja e mëtejshme e masës së pagave¹⁷ dhe rritja, megjithëse pak më e ngadaltë, në masën e pensioneve. Një pjesë e konsumit të amvisërive vijon të financohet nga kreditë bankare, të cilat gjithashtu shënuan rritje të fuqishme reale vjetore në këtë tremujor.


Nga aspekti i të dhënave të disponueshme për konsumin personal¹⁸ për tremujorin e katërt të vitit 2024, ato tregojnë për rritjen e tij të mëtejshme, por më të ngadaltë. Kështu, disa nga komponentët e të ardhurave të disponueshme, përkatësisht pagat, po shënojnë ngadalësim të rritjes, ndërsa pensionet¹⁹ po shënojnë rritje të përshpejtuar. Gjithashtu, rritja reale e kredive për popullsinë po ngadalësohet, megjithëse rezultatet e Anketës për aktivitet kreditor nga dhjetori tregojnë për një lehtësim neto të kushteve të kreditimit dhe rritje neto të kërkesës për kredi për amvisëritë në tremujorin

¹⁷ Më shumë detaje në seksionin 1.4. Punësimi dhe pagat.

¹⁸ Të dhënat për pagat janë duke e përfshirë muajin tetor të vitit 2024, ndërsa të dhënat për kreditë e popullsisë, pensionet, tregtinë me pakicë, prodhimin vendas të mallrave të konsumit, importin e mallrave të konsumit dhe të ardhurat bruto nga TVSH-ja i referohen periudhës tetor-nëntor të vitit 2024.

¹⁹ Në tetor të vitit 2024 u bë rritje lineare e pensioneve për 2500 denarë, në vend të harmonizimit të deritanishëm me normën e rritjes gjashtëmujore të kostonë së jetesës dhe pagës mesatare. Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, rreth 340 mijë pensionistë që e kanë fituar të drejtën e sigurimit pensional deri më 31 gusht, janë të përfshirë në rritjen lineare të pensioneve. Këto ndryshime ligjore parashikojnë edhe një rritje tjetër lineare të pensioneve prej 2.500 denarë në mars të vitit 2025 (me pagesë në prill). Për më shumë informacion shihni në [lidhje](#).


e fundit. Rritje më e ngadaltë është shënuar edhe në importet e mallrave të konsumit dhe të ardhurat bruto nga TVSH-ja, ndërsa prodhimi vendas i mallrave të konsumit dhe tregtia me pakicë kanë shënuar rënie. Për sa i përket treguesit të besimit të konsumatorit²⁰, ai tregon për perceptime më të favorshme për tremujorin e katërt të vitit 2024, si në krahasim me tremujorin e mëparshëm, ashtu edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2023.



1.3.2. Konsumi publik

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, rritja e konsumit publik vazhdoi të përshpejtohej dhe arriti në 13.3% (9% në tremujorin e mëparshëm), me rritje tremujore prej 2.5%. Sipas të dhënave nga buxheti, në këtë periudhë rritje reale është vërejtur pothuajse në të gjitha kategoritë e konsumit publik²¹, në radhë të parë në shpenzimet për mallra dhe shërbime, transfertat në Fondin e Shëndetësisë dhe shpenzimet për paga.

Realizimet në buxhet për periudhën tetor–nëntor të vitit 2024 tregojnë për rritje të mëtjeshme, por më të ngadaltë, reale vjetore të shpenzimeve publike.




²⁰ Anketa e Komisionit Evropian mbi optimizmin e konsumatorëve, duke e përfshirë edhe muajin dhjetor të vitit 2024. Në pamjen grafike, indeksi i besimit të konsumatorit shfaqet si përqindje neto e përgjigjeve. Ky indeks është komponent përbërës i indeksit të përgjithshëm të besimit ekonomik.

²¹Rënie është vërejtur vetëm në transfertat për Fondin për SIPRMV.

1.3.3. Konsumi i investimeve

Pas rënies në tremujorin e dytë, investimet bruto në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan rritje të vogël reale vjetore prej 0.6%, ndërsa në bazë tremujore shënuan rënie prej 1.6%. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje nominale në pjesën e investimeve bruto në mjetet bazë dhe rënie në ndryshimin e stokeve²². Shikuar përmes kategorive treguese të investimeve në mjete bazë, investimet e drejtpërdrejta të huaja dhe kreditë afatgjata për ndërmarrjet në tremujorin e tretë shënuan rritje të përshpejtuar, prodhimi vendas i mallrave kapitale shënoi rritje të vogël, pas rënies në tremujorin e mëparshëm, ndërkohë që punimet e kryera në ndërtimtari dhe të ardhurat nga tatimi mbi fitimin vazhduan të rriteshin, por me ritëm më të ngadaltë se në tremujorin e mëparshëm. Nga ana tjetër, investimet kapitale shtetërore shënojnë rënie më të ngadaltë, por rënie reale shënon edhe importi i mjeteve për punë, në ndryshim nga rritja në tremujorin e mëparshëm.

Për sa i përket të dhënave me frekuencë të lartë për investimet bruto²³ për periudhën tetor - nëntor të vitit 2024, vërehet rritje e përshpejtuar e mbështetjes së kreditimit për ndërmarrjet, e cila është në përputhje me rezultatet e Anketës për aktivitetin kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2024, të cilat tregojnë për lehtësim neto të kushteve të përgjithshme të kreditimit, me rritje të njëkohshme neto të kërkesës për kredi korporative. Rritje e përshpejtuar vërehet edhe në tatimin mbi fitimin, por rritje pas rënies në tremujorin e mëparshëm shënon edhe importi i mjeteve për punë. Gjithashtu, vazhdon rritja e lartë në punimet e kryera ndërtimore. Nga ana tjetër, investimet kapitale shtetërore shënuan rënie të mëtejshme, por dukshëm më të vogël në krahasim me tremujorin e mëparshëm, rënia e prodhimit të përgjithshëm industrial u thellua lehtë, ndërkohë që prodhimi vendas i mallrave kapitale dhe stoqet e mallrave të gatshme shënuan rënie, krahasuar me rritjen e arritur në tremujorin e tretë.





1.3.4. Kërkesa neto për eksport

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, eksportet neto patën kontribut negativ në rritjen e PBB-së. Konkretisht, eksportet e mallrave dhe shërbimeve, pas rënies reale vjetore në pesë tremujorët e mëparshëm, në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan ngecje (normë reale vjetore prej 0%), ndërsa në bazë tremujore u rritën me 0.2%. Lëvizje të ngjashme në bazë vjetore janë vërejtur edhe te importi (norma reale vjetore prej 0%), ndërsa në bazë tremujore ka shënuar rënie prej 0.9%.

²²Sipas njoftimit të ESHS-së për [Produkti i Brendshëm Bruto, tremujori i tretë i vitit 2024](#).

²³ Të dhënat për punimet e përfunduara të ndërtimit dhe stoqet e mallrave të gatshme janë për muajin tetor të vitit 2024, ndërsa të dhënat për kreditë afatgjata për ndërmarrjet, investimet kapitale shtetërore, prodhimin industrial, importet e produkteve investuese dhe prodhimin vendas të mallrave kapitale i referohen periudhës tetor - nëntor të vitit 2024.

Të dhënat për shkëmbimin në tregtinë e jashtme për periudhën tetor-nëntor të vitit 2024 tregojnë për rritje të mundshme të deficitit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me rënie nominale më të madhe të eksporteve se sa importeve të mallrave.




1.4. Punësimi dhe pagat

Tregu i punës në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi zhvillime të moderuara pozitive në bazë vjetore. Kështu, shkalla e punësimit arriti në 46.1%, që paraqet rritje prej 0.4 p.p. krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, me rritje të numrit të të punësuarve për 0.8%. Ndryshim të ngjashëm ka pasur edhe në shkallën e papunësisë (ulje prej 0.5 p.p.), e cila është ulur në nivelin më të ulët historik prej 12.3%, me rënie vjetore të numrit të të papunëve prej 3.7%. Lëvizjet e tilla të parametrave kryesorë të tregut të punës kontribuuan në rritje të popullsisë aktive në bazë vjetore (me 0.2%) dhe ulje të popullsisë joaktive (me 0.4%). Në përputhje me hulumtimet e anketës, në tetor dhe nëntor të vitit 2024, optimizmi i drejtuesve të ndërmarrjeve për punësimet e reja u rrit krahasuar me perceptimet e shprehura gjatë tremujorit të tretë. Në raport me koston e punës, pagat në tremujorin e tretë të vitit 2024 vazhduan të shënojnë rritje dyshifrore në bazë vjetore, por me një ritëm më të ngadaltë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, tregu i punës²⁴ po përjeton zhvillime të moderuara pozitive në bazë vjetore. Kështu, shkalla e punësimit është 46.1%, që është 0.4 p.p. më e lartë krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, me rritje të numrit të të punësuarve me 0.8%. Shikuar sipas veprimtarive të veçanta, kontributin më të rëndësishëm në rritjen vjetore të numrit të të punësuarve e kanë aktivitetet "bujqësi, pylltari dhe peshkim", "industri përpunuese", "ambiente akomodimi dhe veprimtaritë e shërbimit ushqimor" dhe "miniera dhe gurorë". Përkundrejt kësaj, ka pasur rënie më të madhe të numrit të të punësuarve në veprimtarinë e "arsimit". Për sa i përket statusit ekonomik²⁵, rritje vjetore të numrit të të punësuarve ka në kategoritë "të vetëpunësuar" dhe "punëtorë të paguar të familjes", ndërsa rënie ka në kategoritë "të punësuar" dhe "punëdhënës".

²⁴Në këtë informacion tremujor, vazhdojmë me analizën në baza vjetore bazuar në të dhëna të krahasueshme nga viti 2023 e në vazhdim. Krahasimi me vitet e mëparshme është i kufizuar për shkak të zbatimit të Rregullores së re (BE) nr. 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Statistikat Sociale dhe e rregullores ekzekutive përkatëse të Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për lëmin e fuqisë punëtore, me çka është shfuqizuar Rregullorja e mëparshme (KE) nr. 577/98. Zbatimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në hulumtim, duke filluar me ndryshime në pyetësor, ndryshime në radhën e pyetjeve, ndryshime dhe heqje të pyetjeve ekzistuese dhe shtim të pyetjeve të reja, ndryshime në shtrirjen dhe përkufizimin e punësimit dhe të papunësisë.


²⁵Klasifikimi sipas statusit ekonomik i referohet grupeve të mëposhtme: **punëdhënës** - persona që e menaxhojnë subjektin e tyre afarist ose janë pronarë që punojnë në dyqanin e tyre, ose janë pronarë të pronës së tyre bujqësore dhe punësojnë persona të tjerë; **të punësuar** - personat që punojnë në institucione shtetërore, subjekte afariste në pronësi shoqërore, të përzier, kooperativa



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Anketa për fuqinë punëtore.

Shënim: Të dhënat nga tremujori i parë i vitit 2023 e në vazhdim përmbajnë ndryshim metodologjik, me të cilin është bërë një ndërprerje statistikore në seri.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, sipas anketave të tendencave të biznesit²⁶, treguesi i pritjeve të punësimit tregon rritje të optimizmit tek drejtuesit e subjekteve të biznesit. Kështu, pritjet në ndërtimtari dhe tregtinë me pakicë për rritjen e ardhshme të numrit të të punësuarve janë më të favorshme, ndërkohë që pritjet në industri dhe në sektorin e shërbimeve janë përkeqësuar krahasuar me perceptimet e shprehura në tremujorin e mëparshëm dhe në të njëjtin tremujor të një viti më parë.



Burimi: Komisioni Evropian, Anketat për tendencat e biznesit.

* Pritjet për numrin total të punësimeve gjatë 3 muajve të ardhshëm e udhëheqësve të ndërmarrjeve në industri, sektorin e shërbimeve, tregtinë me pakicë dhe ndërtimin.


Shkalla e vendeve të lira të punës²⁷ është relativisht e qëndrueshme, kështu që në tremujorin e tretë të vitit 2024 është 2.0% (1.9% në tremujorin e mëparshëm). E parë sipas veprimtarive, përqindjet

dhe me pronësi të papërcaktuar ose te punëdhënës privat; **të vetëpunësuar** - personat të cilët kanë subjekt afarist, biznes, kryejnë veprimtari në mënyrë të pavarur dhe punojnë në pronë bujqësore për të krijuar të ardhura dhe nuk punësojnë persona të tjerë; **punëtorë të papaguar të familjes** – personat që punojnë pa pagesë në një subjekt afarist, dyqan apo pronë bujqësore (në pronësi të një anëtarit të familjes së tyre).

²⁶Burimi: Komisioni Evropian, anketa mbi tendencat e biznesit, pritjet e punësimit në 3 muajt e ardhshëm në industri, shërbime, tregti me pakicë dhe ndërtimtari.

²⁷ Shkalla e vendeve të lira të punës është raporti midis numrit të vendeve të lira të punës dhe numrit të përgjithshëm të vendeve të punës. Zakonisht, shkalla e vendeve të punës shqyrtohet së bashku me shkallën e papunësisë (një marrëdhënie e njohur si kurba Beveridge). Vendosja e këtyre dy treguesve jep informacion mbi efikasitetin e tregut të punës për sa i përket mospërputhjeve të mundshme midis profileve të kërkuara dhe atyre që disponohen në tregun e punës në një moment të caktuar (në anglisht skill mismatches). Konkretisht, nëse të dy treguesit lëvizin në të njëjtën kohë, bëhet fjalë për luhatje të përkohshme, ciklike, ndërsa në rastin kur shkalla e papunësisë ulet, me normë të qëndrueshme të vendeve të lira, bëhet fjalë për ndryshime strukturore, përkatësisht për efikasitet më të mirë të tregut të punës.

më të larta të vendeve të lira janë në veprimtaritë "objekte akomodimi dhe shërbime ushqimore" (3,4%), "veprimtaritë administrative dhe të shërbimeve ndihmëse" (3,3%), "art, argëtim dhe rekreacion" (3,1%), "tregti" (2,8%) dhe "arsim" (2,6%).



Burimi: Enti Shtetëror Statistikor.

Shënim: Të dhënat për normën e aktivitetit nga tremujori i parë i vitit 2023 e në vazhdim përmbajnë ndryshim metodologjik, i cili ka krijuar ndërprerje statistikore në seri.

Nga aspekti i ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e tretë të vitit 2024 popullsia aktive shënoi rritje prej 0,2% në bazë vjetore, shoqëruar me ulje të popullsisë joaktive prej 0,4%, me të cilën shkalla e aktivitetit u rrit me 0,2 p.p. në bazë vjetore dhe arrin në 52.6%.


Rritja më e fuqishme e kërkesës për fuqi punëtore sesa rritja e ofertës për fuqi punëtore çoi në ulje të mëtijshme të papunësisë në tremujorin e tretë të vitit 2024. Kështu, numri i personave të papunë u ul me 3,7% në bazë vjetore, gjë që solli edhe uljen e shkallës së papunësisë, e cila u ul në 12,3% (12,8% në tremujorin e tretë të vitit 2023).

Paga mesatare e paguar në vend vijon të shënojë rritje vjetore dyshifrore në bazë neto dhe bruto në tremujorin e tretë të vitit 2024, por më të ngadaltë krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Kështu, rritja nominale vjetore e pagës mesatare neto dhe bruto është përkatësisht 11.8% dhe 12.1% (në tremujorin e mëparshëm rritje përkatësisht 13.9% dhe 14.1%). Rritja vjetore e pagave në këtë tremujor e reflekton në masë të madhe edhe efektin mbartës të rritjes së pagave të punonjësve të sektorit publik²⁸ në shtator të vitit 2023, por pjesërisht është rezultat edhe i rritjes së pagës minimale bruto me 12.15% në mars të vitit 2024²⁹ dhe rrjedhimisht rritjes lineare të pagave në administratën shtetërore. Në rritjen e pagave kontribuon edhe qëndrueshmëria e disa faktorëve strukturorë, siç është mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara të tregut të punës, e cila pjesërisht reflektohet në përqindjet e vendeve të lira të punës në veprimtari të caktuara. Analizuar sipas veprimtarive, rritje vjetore e pagave është vërejtur në të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe veçanërisht në veprimtaritë: art, argëtim dhe rekreacion, "arsim", "administratë publike dhe mbrojtje", "furnizim me ujë", "industri prodhuese", "veprimtari financiare dhe ato të sigurimit" dhe "transport dhe magazinim". Në kushtet e rritjes së çmimeve të konsumit prej 2.6%, **pagat reale neto dhe bruto në tremujorin e tretë u rritën përkatësisht me 9.0% dhe 9.2%, në bazë vjetore, që paraqet ngadalësim në krahasim me rritjen në tremujorin e mëparshëm.** Në tetor të vitit 2024, rritja

²⁸Në përputhje me marrëveshjen e re kolektive për sektorin publik nga korriku i vitit 2023, pagat në sektorin publik u rritën me 10% në shtator të vitit 2023.

²⁹Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e fundit ligjore për rritjen e pagës minimale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 68/24) nga marsi i vitit 2024, paga minimale neto është rritur për 2.392 denarë. Lartësia e pagës minimale në shumën bruto, duke filluar nga marsi i vitit 2024 deri në shkurt të vitit 2025, është 33.352 denarë (më parë 29.739 denarë), ndërsa në shumë neto 22.567 denarë (më parë 20.175 denarë). Kjo rritje është llogaritur në përputhje me metodologjinë e marsit të vitit 2022, me të cilën paga minimale harmonizohet me rritjen e pagës mesatare të paguar në vend dhe me indeksin e kostos së jetesës në vitin e mëparshëm, përkatësisht 50% të rritjes së secilit tregues. Gjithashtu, është përcaktuar se paga minimale nuk mund të jetë më e ulët se 57% e shumës së pagës mesatare neto të paguar në RMV për vitin e mëparshëm.

vjetore e pagës mesatare neto u ngadalësua më tej, në 8.5% në terma nominalë dhe 4.8% në terma realë.



1.5. Inflacioni

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, norma vjetore e inflacionit u përshpejtua në 4.1% (2.6% në tremujorin e mëparshëm) për shkak të çmimeve të ushqimeve. Rritja e përshpejtuar e komponentit ushqimor pritet dhe vjen kryesisht si rezultat i bazës më të ulët krahasuese nga viti i kaluar, për shkak të masave të marra në atë kohë për ta kufizuar përkohësisht rritjen e çmimeve që ishin në fuqi në muajt e fundit të vitit. Kjo është zbutur pjesërisht nga masa e këtij viti për kufizimin e marzhit të fitimit në tregtimin e disa produkteve ushqimore bazë. Lëvizjet në përbërësit e mbetur të inflacionit janë të favorshme, përkatësisht inflacioni bazë pothuajse ka ngecur në bazë vjetore, me lëvizje minimale që e reflekton rritjen e çmimeve të duhanit për shkak të rritjes së akcizës. Çmimet e energjisë vazhduan të bien, me rënie të çmimeve të të gjitha lëndëve djegëse. Për të gjithë vitin 2024, norma mesatare vjetore e inflacionit është në përputhje me pritjet dhe arrin në 3.5%. Përsa i përket faktorëve që do të ndikonin në dinamikën e ardhshme afatshkurtër të çmimeve të konsumit, edhe në tremujorin e katërt, çmimet e prodhimit vendas të produkteve industriale pësuan rritje të përshpejtuar, në kushtet e një norme të qëndrueshme të inflacionit të importuar. Sa i përket pritjeve për normën e inflacionit në periudhën e ardhshme, sipas Anketës së Bankës Popullore, analistët ekonomik presin ngadalësim të mëtejshëm të tij, ngjashëm me dinamikën e parashikuar të inflacionit të Bankës Popullore dhe institucioneve ndërkombëtare.


1.5.1. Inflacioni aktual

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, norma vjetore e inflacionit arriti në 4.1% (2.6% në tremujorin e mëparshëm)³⁰. Përshpejtimi i rritjes së çmimeve në këtë periudhë vjen si pasojë e çmimeve të komponentit ushqimor në një bazë më të ulët krahasuese³¹, si dhe e rritjes minimale më të lartë të inflacionit bazë. Nga ana tjetër, çmimet e lëndëve djegëse vazhdojnë të bien. Në këtë tremujor ka pasur masa për uljen e çmimeve. Kështu, nga fundi i shtatorit deri në fund të tetorit, u vendos një masë për

³⁰ Në bazë tremujore, çmimet e konsumit të brendshëm rezultuan më të larta me 0.4%, ndërsa në bazë të përshtatjes sezonale me 1.0%.

³¹ Baza më e ulët e krahasimit lidhet me masat e vitit të kaluar për kufizimin e përkohshëm të rritjes së çmimeve, ndërsa masa e këtij viti për kufizimin e marzhit të fitimit zgjati më pak se një muaj (nga 24 shtatori deri më 31 tetor të vitit 2024).

kufizimin e marzhit të fitimit në tregtinë e disa produkteve ushqimore bazë³², e cila kontribuoi në zbutjen e efekteve të bazës së krahasimit në çmimet e ushqimeve. Gjithashtu, nga mesi i dhjetorit filloi zbatimi i të ashtuquajturës "Shporta konsumatore e Vitit të Ri", që është ulje promovuese e çmimeve të disa produkteve ushqimore, pijeve alkoolike dhe joalkoolike që janë më të shiturat gjatë festave të Vitit të Ri dhe që do të duhet të shiten me çmime më të ulëta për të paktën 10% në periudhën nga 15 dhjetori i vitit 2024 deri më 15 janar të vitit 2025³³.



Rritja vjetore e çmimeve të ushqimeve në tremujorin e katërt të vitit 2024 u përshpejtua dhe shënoi mesatarisht 4.3% (0.5% në tremujorin e mëparshëm). Kjo lëvizje rritëse e çmimeve të ushqimeve vjen kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve në kategorinë "perime", e cila shënoi rënie në tremujorin e mëparshëm, si dhe rritjes më të fuqishme të çmimeve në kategoritë "qumësht, djathë dhe vezë" dhe "mish". Kjo lëvizje vjen kryesisht si rezultat i rënies së bazës krahasuese nga viti i kaluar, kur ishin në fuqi masat e sipërpërmendura për kufizimin e përkohshëm të rritjes së çmimeve, por në fund të tetorit pushoi së qeni e vlefshme edhe masa për kufizimin e marzhit të fitimit në tregtinë e disa produkteve ushqimore bazë. Nga aspekti i faktorëve për lëvizjen e ardhshme të inflacionit³⁴ gjatë kësaj periudhe, çmimet botërore të produkteve ushqimore bazë shënuan rritje, pas një periudhe më të gjatë rënieje, kurse rritje më e lartë u shënuar edhe në çmimet e shitjes së prodhuesve vendas të ushqimit, si dhe në çmimet e huaja efektive të ushqimeve të shprehura në euro³⁵.

³² Masa ishte në fuqi nga data 24 shtator deri më 31 tetor të vitit 2024, sipas së cilës marzhi më i lartë bruto i fitimit për produktet e përfshira nga masa u përcaktua në shumë totale deri në 10% në tregtinë me shumicë dhe deri në 10% në tregtinë me pakicë për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në zinxhirin tregtar ([lidhje](#)).

³³Ajo që ndryshon nga masat e mëparshme është se kjo nuk është një masë ndërhyrjeje, nuk është kufizim i çmimeve, por marrëveshje me të gjithë palët e interesuara dhe do të kontrollohet vetëm nëse respektohet marrëveshja, me të cilën duhet të ulen çmimet e produkteve të dakorduara me të paktën 10%, të cilat janë përzgjedhur me konsensus të ndërsjellë (për më shumë, shih në [lidhjen](#)). Listën dhe numrin e produkteve dhe kompanive të përfshira në të ashtuquajturën "Shporta konsumatore e Vitit të Ri" mund ta gjeni në [lidhjen](#). Një masë e tillë pritet të ketë efekt të favorshëm vetëm në normën e inflacionit në janar të vitit 2025 për shkak të mënyrës së regjistrimit të çmimeve nga ESHS-ja.

³⁴Veç kësaj, në përputhje me periudhën e aplikimit të së ashtuquajturës "Shporta konsumatore e Vitit të Ri" dhe periudha e regjistrimit të çmimeve pritet të kenë efekte të favorshme në normën e inflacionit në tremujorin e ardhshëm.


³⁵ Të dhënat për çmimet e shitjeve të prodhuesve vendas të ushqimeve dhe çmimet e huaja efektive të ushqimeve u referohen dy muajve të parë të tremujorit të katërt të vitit 2024.



	ndryshimet vjetore, në%										kontributet në ndryshimet vjetore, në p.p.									
	2023				2023	2024				2024	2023				2023	2024				2024
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4		Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4		Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4		Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	
Indeksi i çmimeve të konsumit - gjithsej	16.1	11.2	7.7	3.4	9.4	3.4	3.9	2.6	4.1	3.5	16.1	11.2	7.7	3.4	9.4	3.4	3.9	2.6	4.1	3.5
Ushqimet	24.6	14.5	10.2	0.8	11.8	2.4	3.5	0.5	4.3	2.7	8.6	5.3	3.8	0.3	4.3	0.9	1.3	0.2	1.6	1.0
Çmimet e energjisë	15.3	9.2	3.7	2.2	7.3	0.5	1.8	-2.4	-2.7	-0.7	2.0	1.2	0.5	0.3	1.0	0.1	0.2	-0.3	-0.3	-0.1
Energjia elektrike	14.0	14.0	8.1	8.1	10.9	2.7	2.7	-0.9	-0.9	0.8	1.0	1.0	0.6	0.6	0.8	0.2	0.2	-0.1	-0.1	0.1
Ngrohja qendrore	14.2	14.2	4.3	2.3	8.4	3.5	3.5	1.5	-1.8	1.6	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Karburantet dhe lubrifikantët	4.2	-14.3	-13.3	-8.6	-8.5	-2.4	3.9	-5.6	-6.4	-2.7	0.1	-0.5	-0.5	-0.3	-0.3	-0.1	0.1	-0.2	-0.2	-0.1
Ushqimi dhe energjia (çmime të luhatshme)	22.2	13.2	8.5	1.1	10.7	1.9	3.1	-0.2	2.5	1.8	10.7	6.5	4.3	0.6	5.3	1.0	1.5	-0.1	1.3	0.9
Inflacioni bazë i llogaritur nga BPRMV-ja (indeksi total pa ushqimet dhe energjinë (kategoritë 01.1, 04.5, 07.2.2))	10.2	9.1	7.0	5.9	8.0	5.0	4.8	5.5	5.6	5.2	5.3	4.6	3.5	2.9	4.0	2.4	2.4	2.7	2.8	2.6
Indeksi total me përjashtim të energjisë, karburanteve dhe lubrifikantëve dhe ushqimit të papërpunuar (ESHS-ja)	15.8	11.2	7.2	3.7	9.3	3.3	4.6	4.3	4.9	4.3										
Indeksi total me përjashtim të energjisë, karburanteve dhe lubrifikantëve, ushqimit të papërpunuar, duhanit dhe pijeve alkoolike (ESHS-ja)	16.6	11.4	7.2	3.4	9.4	2.7	4.5	4.2	4.6	4.0										

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor dhe llogaritje të BPRMV-së.

Dhe në tremujorin e katërt të vitit 2024, çmimet e energjisë vazhduan të ulen dhe shënuan rënie vjetore prej 2,7% (rënie prej 2,4% në tremujorin e mëparshëm), e cila në masë të madhe erdhi sërish si pasojë e uljes së çmimeve të derivateve të naftës, në përputhje me lëvizjet në bursat botërore. Në kushte të korigjimit minimal në korrik të vitit 2024, kontribut negativ kanë edhe çmimet e energjisë elektrike³⁶ për shkak të uljes së çmimeve në fillim të vitit 2024 dhe efektit bazë që lidhet me rritjen e çmimeve nga korriku i vitit 2023. Gjithashtu, me uljen e çmimeve të ngrohjes qendrore në muajin gusht³⁷, në këtë tremujor edhe ato kanë shënuar rënie.



* Çmimet e huaja efektive të ushqimit paraqesin përmblendhje e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve. Burimi: EShS-ja, Eurostat dhe llogaritje të BPRMV-së.

Burimi: EShS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.

Inflacioni bazë në tremujorin e katërt të vitit 2024 u përshpejtua minimalisht, duke arritur në 5.6% në bazë vjetore (5.5% në tremujorin e mëparshëm), që është kryesisht një refleks i rritjes më të fuqishme tremujore të çmimeve të duhanit³⁸ si pasojë e rritjes së akcizës dhe rritjes së çmimeve të shërbimeve të hotelierisë. Për këtë arsye, këto çmime e kanë edhe kontributin më të madh në inflacionin bazë në këtë tremujor, ndërsa kontribut më të rëndësishëm kanë çmimet e pijeve joalkoolike, shërbimet e akomodimit si dhe kategoritë "banim", "mobilitet, pajisje dhe mirëmbajtje e pajisjeve" dhe "veshje dhe këpucë". Në raport me nënindekset e tjera të inflacionit, të cilët i përjashtojnë çmimet më të ndryshueshme, ata shënuan përshpejtim të lehtë të rritjes në këtë tremujor. Kështu, në indeksin total pa energjinë³⁹, lëndët djegëse të lëngëta dhe lubrifikantët (për transport) dhe ushqimet e papërpunuara, rritja vjetore është 4.9% (4.3% në tremujorin e mëparshëm), ndërsa në indeksin total pa

³⁶Në përputhje me projektvendimin e përgatitur për përcaktimin e çmimeve të shitjes nga Furnizuesi Universal, dhe i konfirmuar nga KRRE-ja për zbatimin e duhur të sistemit tarifor, nga data 1 korrik 2024 filluan të zbatohen çmimet e reja të energjisë elektrike për konsumatorët e vegjël/amvisëritë ([lidhje](#)). Në përputhje me të, për 88% të amvisërive në bllokun e parë dhe të dytë, çmimi i energjisë elektrike ka korigjim prej 0.4%. Për ata konsumatorë që janë në bllokun e tretë, që është rreth tetë për qind e amvisërive, çmimi rritet me 0,48 për qind dhe për bllokun e katërt çmimi rritet me 0,57 për qind ([lidhje](#)).


³⁷Komisioni Rregullator i Energjisë (KRRE) ka marrë vendim sipas të cilit nga gushti, çmimet e energjisë për ngrohje për amvisëritë do të jenë më të ulëta për 3.16% ([lidhje](#)).

³⁸Në përputhje me ndryshimet e miratuara në Ligjin për akciza, akciza për cigaret është rritur për 0,23 denarë për copë, që zbatohet nga janari i vitit 2024. Në tremujorin e fundit të vitit, cigaret u shtrenjtuan për 10 denarë shtesë ([lidhje](#)). Për sa i përket produkteve të tjera të duhanit, ndryshimet mund të shihen në [lidhjen](#). Gjithashtu, akciza pritet të rritet çdo vit deri në vitin 2030.

³⁹Kategoria "energji" i referohet energjisë elektrike, gazit, lëndëve djegëse të lëngshme dhe të ngurta për ngrohje dhe ngrohjes qendrore.

energjinë, lëndët djegëse të lëngëta dhe lubrifikantët (për transport), ushqimet e papërpunuara, duhanin dhe pijet alkoolike rritja vjetore është 4.6% (4.2% në tremujorin e mëparshëm).

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, çmimet e prodhimit të mallrave industriale shënuan rritje vjetore prej 6,0%⁴⁰, që paraqet përshpejtim krahasuar me rritjen në tremujorin e mëparshëm (4,2%). Për më tepër, rritja e çmimeve të mallrave të konsumit këtë tremujor ka pasur edhe kontributin më të madh në rritjen e përgjithshme të çmimeve të prodhimit, ndërsa kontribut pozitiv kanë pasur edhe çmimet e energjisë. Nga aspekti i veprimtarive të veçanta, edhe këtë tremujor, rritja rrjedh në masë të madhe nga rritja e çmimeve të lëndëve djegëse, çmimeve të ushqimeve dhe pijeve. Kështu, **çmimet e prodhimit të energjisë dhe të mallrave për konsum të gjerë**, si kategori agregate dhe si një nga faktorët që ndikojnë në dinamikën e çmimeve të konsumit, shënuan rritje prej 10.0%, që paraqet përshpejtim krahasuar me rritjen në tremujorin e mëparshëm (7.7%). Nga ana tjetër, **inflacioni i huaj efektiv**⁴¹, si indikator tregues i inflacionit të importuar, në tremujorin e katërt, shënoi normë rritjeje vjetore prej 2.7%, e cila ishte e njëjtë me tremujorin e mëparshëm.



Në tremujorin e katërt të vitit 2024, ka pasur **përshpejtim të rritjes së çmimeve të apartamenteve** të matura nëpërmjet indeksit hedonik⁴², i cili arriti në 10.6% në bazë vjetore (8.0% në tremujorin e mëparshëm). Nga aspekti i ofertës, në tremujorin e tretë të vitit 2024, vlera e ndërtesave të banimit të ndërtuara shënoi rritje të mëtijshme, por më të ngadaltë, me 9.9% në bazë vjetore (13.7% në tremujorin e mëparshëm). Të dhënat e disponueshme për vlerën e lejeve të dhëna për ndërtimin e objekteve të banimit për tremujorin e katërt të vitit 2024⁴³ tregojnë aktualisht rritje të mëtijshme të lartë vjetore, në kushtet e një baze të ulët krahasuese. Nga aspekti i kërkesës për banesa, në këtë periudhë vihet re përshpejtim i lehtë i rritjes vjetore të kredisë për banesa⁴⁴.



⁴⁰ Analiza e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale i referohet dy muajve të parë të tremujorit të katërt të vitit 2024.

⁴¹ Për llogaritja e inflacionit të jashtëm efektiv është nxjerrë nga shuma e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerë më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të mallrave të konsumit. Struktura e ponderimit bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili prej vendeve në totalin e importit nominal në periudhën 2016 - 2018. Në llogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia, Serbia, Polonia dhe Spanja. E dhëna i referohet dy muajve të parë të tremujorit të katërt të vitit 2024.

⁴² Indeksi hedonik i çmimeve të banesave, i përgatitur nga BPRMV-ja mbi bazën e shpalljeve për shitje në kryeqytet dhe i publikuar nga agjencitë që merren me transaksionet e pasurive të paluajtshme. Çmimi i një apartamenti është në funksion të zonës, lagjes ku ndodhet, katit, nëse apartamenti ka ngrohje qendrore dhe nëse apartamenti është i ri.

⁴³ Analiza i referohet muajit të parë të tremujorit të katërt të vitit 2024.

⁴⁴ Të dhëna të disponueshme për dy muajt e parë të tremujorit të katërt të vitit 2024.



1.5.2. Pritshmëritë për inflacionin

Lidhur me ecurinë e pritur të normës së inflacionit, institucionet vendase dhe ndërkombëtare parashikojnë një prirje rënëse të rritjes së çmimeve të konsumit në periudhën në vijim. Të ngjashme janë edhe pritshmëritë e analistëve ekonomikë të anketuar, të shprehura në kuadrin e **Anketës për pritjet e inflacionit dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale**⁴⁵, të kryer në dhjetor të vitit 2024, sipas së cilës ata parashikojnë të ulet në nivelin 3.5% në vitin 2024, 3.0% në vitin 2025 dhe 2.5% në vitin 2026, në përputhje me pritjet për presione më të moderuara të çmimeve për shkak të stabilizimit gradual të çmimeve të ushqimeve dhe të lëndëve djegëse, masave të marra nga hartuesit e politikave, si dhe ngadalësimit të inflacionit të jashtëm.

Parashikimet dhe pritjet për normën e inflacionit

	2024	2025	2026
Analistë ekonomik	3.5	3.0	2.5
FMN-ja	3.3	2.3	2.0
Consensus Forecast	3.6	3.1	
Ministria e Financave	3.5	2.2	2.0
BPRMV-ja	3.5	2.5	2.0

Burimi: Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale, dhjetor 2024; FMN-ja, Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2024; Consensus Forecast, dhjetor 2024; Ministria e Financave, Strategjia fiskale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 2025-2029, shtator 2024; dhe BPRMV-ja, tetor 2024.



Presionet më të dobëta nga çmimet e energjisë kanë ndikim pozitiv në pritjet për lëvizjet e ardhshme afatshkurtra të çmimeve në segmentin e ndërtimtarisë dhe në sektorin e shërbimeve. Kështu, në kuadër të **sektorit të korporatave**⁴⁶, në tremujorin e katërt të vitit 2024, mesatarisht, pritshmëritë për lëvizje të çmimeve në tre muajt e ardhshëm janë më të favorshme në sektorin e ndërtimtarisë dhe atë të shërbimeve, ku ka një rënie të numrit të drejtuesve të ndërmarrjeve që presin rritje të çmimeve të produkteve të tyre, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Nga ana tjetër, pritshmëritë për rritje të çmimeve mbizotërojnë në industrinë përpunuese dhe tregtinë me pakicë. Për sa i përket **pritjeve të konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm**⁴⁷, pothuajse është i

⁴⁵ Duke filluar nga tetori i vitit 2017, BPRMV-ja bëri ndryshim në hulumtimin e mëparshëm "Anketë për pritshmëritë e inflacionit". Hulumtimi i ri "Anketë për pritshmëritë për inflacionin dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale" është kryer mbi një numër të caktuar analistësh ekonomikë, por është zgjeruar edhe lënda e Anketës, në përputhje me praktikën e Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Rezultatet e Anketës mund të gjenden në [lidhje](#).

⁴⁶ Anketat për tendencat e biznesit të Komisionit Evropian në industri, tregti me pakicë, ndërtimtari dhe në sektorin e shërbimeve përfshirë dhjetorin e vitit 2024.

⁴⁷ Anketa e Komisionit Evropian mbi optimizmin e konsumatorëve, duke e përfshirë edhe muajin dhjetor të vitit 2024.

barabartë numri i personave që presin ulje të çmimeve në 12 muajt e ardhshëm me ata që presin rritje të çmimeve, por ende mbizotërojnë pritshmëritë për uljen e çmimeve.



1.6. Bilanci i pagesave

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, llogaria rrjedhëse shënoi suficit prej 1.8% të PBB-së, që është përmirësim i lehtë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Faktor kryesor i përmirësimit të arritjeve është suficiti më i lartë në shërbime, i cili vjen si pasojë e deficitit dukshëm më të ulët në shërbimet e ndërtimtarisë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur janë realizuar paradhënie më të mëdha për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d, si dhe suficiti më i lartë tek udhëtimet. Nga ana tjetër, efekt të kundërt pati suficiti më i ulët në të ardhurat dytësore, i ndikuar kryesisht nga flukset më të ulëta hyrëse në transfertat private, si dhe deficiti pak më i lartë në të ardhurat primare. Në llogarinë financiare, gjatë tremujorit të tretë, janë realizuar flukse dalëse mbi bazë neto, si rezultat i daljeve neto të realizuara në shumicën e kategorive, kompensuar në një masë të konsiderueshme nga flukse të mëtejshme të qëndrueshme neto nga IHD-të. Edhe gjatë kësaj periudhe rezervat valutore mbeten në zonën e sigurt.




	2023					2024					2023					2024				
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-XII	Tr.1	Tr.2	Tr.3	I-IX		Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	I-XII	Tr.1	Tr.2	Tr.3	I-IX	
Në milionë euro										% nga PBB-ja										
I. Llogaria rrjedhëse	78.6	-126.7	229.1	-125.4	55.6	-190.4	-104.9	263.3	-32.0		0.5	-0.9	1.6	-0.9	0.4	-1.3	-0.7	1.8	-0.2	
Mallra dhe shërbime, neto	-366.2	-581.9	-341.1	-609.3	-1898.6	-512.9	-497.3	-265.9	-1276.2		-2.5	-4.0	-2.3	-4.2	-13.0	-3.5	-3.4	-1.8	-8.8	
Eksport	2414.4	2483.2	2478.9	2510.4	9886.8	2290.8	2412.3	2528.9	7232.1		16.6	17.0	17.0	17.2	67.8	15.8	16.7	17.5	49.9	
Import	2780.6	3065.1	2820.0	3119.7	11785.4	2803.8	2909.7	2794.9	8508.3		19.1	21.0	19.3	21.4	80.8	19.4	20.1	19.3	58.7	
Mallra, neto	-620.5	-596.4	-634.0	-783.2	-2634.1	-816.1	-740.3	-632.3	-2188.7		-4.3	-4.1	-4.3	-5.4	-18.1	-5.6	-5.1	-4.4	-15.1	
Shërbime, neto	254.3	14.5	292.9	173.9	735.5	303.1	243.0	366.4	912.5		1.7	0.1	2.0	1.2	5.0	2.1	1.7	2.5	6.3	
Të hyrat primare, neto	-183.0	-184.4	-189.6	-185.4	-742.4	-196.9	-193.2	-197.8	-588.0		-1.3	-1.3	-1.3	-1.3	-5.1	-1.4	-1.3	-1.4	-4.1	
Të hyrat sekundare, neto	627.8	639.7	759.8	669.4	2696.6	519.4	585.7	727.0	1832.2		4.3	4.4	5.2	4.6	18.5	3.6	4.0	5.0	12.6	
II. Llogaria kapitale	0.2	-0.5	-0.5	-0.1	-0.9	0.0	0.5	-0.3	0.3		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Huadhënie neto (+) / huamarrje neto (-) (bilanci apo përmblledhja nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale)	78.8	-127.2	228.5	-125.5	54.7	-190.4	-104.3	263.0	-31.7		0.5	-0.9	1.6	-0.9	0.4	-1.3	-0.7	1.8	-0.2	
III. Llogaria financiare	-191.1	-172.1	565.2	-709.2	-507.2	109.3	-78.5	276.3	307.1		-1.3	-1.2	3.9	-4.9	-3.5	0.8	-0.5	1.9	2.1	
Investime direkte	-129.5	-119.7	-40.1	-198.8	-488.1	-268.8	-209.3	-237.0	-715.1		-0.9	-0.8	-0.3	-1.4	-3.3	-1.9	-1.4	-1.6	-4.9	
Investime të portofolit	-438.5	20.0	414.9	37.6	34.0	67.0	47.3	106.8	221.1		-3.0	0.1	2.8	0.3	0.2	0.5	0.3	0.7	1.5	
Valuta dhe depozita	124.0	120.1	268.1	-99.5	412.7	174.3	89.2	140.3	403.8		0.9	0.8	1.8	-0.7	2.8	1.2	0.6	1.0	2.8	
Kreditë	163.7	-174.2	-8.1	-384.9	-403.5	23.0	-48.2	69.7	44.5		1.1	-1.2	-0.1	-2.6	-2.8	0.2	-0.3	0.5	0.3	
Kreditë tregtare dhe avanset	84.9	-17.7	-69.8	-63.6	-66.2	115.2	43.1	199.8	358.2		0.6	-0.1	-0.5	-0.4	-0.5	0.8	0.3	1.4	2.5	
Llogari tjerë për arkëtim/pagesa	5.0	0.1	0.1	0.1	5.2	-0.3	0.4	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
IV. Të drejta të veçanta të tërheqjes (krijimi i detyrimeve neto)	0.2	0.2	0.1	0.1	0.7	-0.1	0.0	-0.1	-0.1		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
V. Gabime dhe lëshime neto	-3.2	7.3	27.9	9.0	41.1	7.8	41.3	9.9	59.0		0.0	0.1	0.2	0.1	0.3	0.1	0.3	0.1	0.4	
VI. Rezervat devizore	266.7	52.3	-308.7	592.8	603.1	-291.9	15.4	-3.4	-279.9		1.8	0.4	-2.1	4.1	4.1	-2.0	0.1	0.0	-1.9	

Burimi: BPRMV.

1.6.1. Llogaria rrjedhëse


Në tremujorin e tretë të vitit 2024, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave shënoi **suficit prej 263.3 milionë euro, ose 1.8% të PBB-së⁴⁸**. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, është arritur përmirësim i lehtë prej 0.2 p.p. i PBB-së, i cili është tërësisht për shkak të suficitit më të lartë në shërbime. Përkatesisht, arrijtjet më të mira të shërbimit në këtë periudhë janë kryesisht rezultat i deficitit më të ulët në shërbimet e ndërtimtarisë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur janë realizuar flukse dalëse më të mëdha lidhur me ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d, si dhe kontribut shtesë ka edhe suficiti më i lartë i realizuar tek udhëtimet. Nga ana tjetër, suficiti më i ulët i të ardhurave dytësore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si rezultat i flukseve më të ulëta hyrëse në transfertat private, si dhe deficitit pak më i lartë në të ardhurat primare, kishin ndikim negativ në transaksionet rrjedhëse krahasuar me arrijtjet e tremujorit të tretë të vitit të kaluar.



⁴⁸Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (që nga tetori i vitit 2024), e cila nuk i pasqyron rishikimet në rritje të PBB-së të bëra nga ESHS-ja për vitet 2022 dhe 2023.

Shtojca 1: Shkëmbimi i jashtëm tregtar dhe lëvizja e kursit nominal dhe real efektiv të këmbimit (KNEK dhe KREK)⁴⁹

Shkëmbimi i jashtëm tregtar në tremujorin e tretë të vitit 2024 arriti në 4,593.3 milionë euro, përkatësisht 31.7% të PBB-së, që krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë paraqet rënie prej 2.2% (ose 0.5 p.p. të PBB-së). Shkëmbimi më i ulët tregtar me jashtë rezulton nga përshtatja e mëtejshme në rënie e komponentit të eksportit, në kushtet e rënies vjetore të importit të mallrave në këtë tremujor.





Në tremujorin e tretë të vitit 2024, eksportet e mallrave shënuan rënie prej 2.9% në bazë vjetore, më e moderuar krahasuar me tremujorët e mëparshëm. Ulja e eksporteve vijon të jetë kryesisht pasojë e kontributit negativ të eksporteve të produkteve kimike të lidhura me industrinë e automobilave. Kontribut negativ ka shënuar edhe eksporti i automjeteve, ndërsa rënia e eksporteve, edhe pse më e moderuar, është vërejtur edhe në disa nga sektorët tradicionalë të eksportit, para së gjithash të veshjeve dhe tekstileve, e më pas edhe në hekur dhe çelik. Në këtë tremujor, kontribut negativ ka pasur edhe ulja e eksportit të derivateve të naftës. Për rënien më të moderuar vjetore të eksporteve, kontribut kryesor ka dhënë përmirësimi i arritjeve në disa sektorë të tjerë të eksportit të ekonomisë vendase. Kështu, eksportet e pajisjeve dhe makinerive u rritën në bazë vjetore, gjë që tregon për arritjet e mira të pjesës tjetër të kapaciteteve të industrisë së automobilave, të vërejtura edhe në këtë tremujor. Gjithashtu, rritje ka pasur eksporti i duhanit, energjisë elektrike dhe xeheve. **Importet e mallrave në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan rënie prej 1.8% në bazë vjetore.** Ndryshimi e reflekton zvogëlimin e importeve të lëndëve të para të industrisë, kryesisht për shkak të reduktimit të importeve të metaleve me ngjyra, dhe më pas të komponentit energjetik, përkatësisht importit më të ulët të derivateve të naftës dhe gazit natyror, me importe më të larta të energjisë elektrike (që është tërësisht për shkak të rritjes së çmimeve). Kontribut më të vogël negativ ka pjesa tjetër e importeve të industrisë, që vërehet përmes importit më të ulët të hekurit, çelikut dhe xeheve. Nga ana tjetër, edhe në këtë tremujor është shënuar rritje e importit të automjeteve dhe importi disi më i lartë i pajisjeve dhe makinerive. **Arritjet në të dy komponentët e tregtisë së jashtme në tremujorin e tretë të vitit 2024 çuan në zgjerimin e deficitit tregtar me 1.2% në bazë vjetore,** në kushtet e rritjes së deficitit në bilancin joenergjetik, duke e ulur njëkohësisht deficitin në bilancin energjetik.



Të dhënat më të fundit që disponohen për periudhën tetor-nëntor të vitit 2024 tregojnë për rënie të mëtejshme si në komponentin e eksportit ashtu edhe të importit të shkëmbimit të jashtëm tregtar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kështu, eksportet e mallrave në muajt tetor - nëntor të vitit 2024 janë 4,8% më të ulëta se eksportet në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndryshimi vjetor i eksporteve i reflekton në masë të madhe arritjet e disa kapaciteteve të industrisë së automobilave, përkatësisht uljen e eksporteve të produkteve kimike, ndonëse edhe eksportet e automjeteve shënuan rënie të mëtejshme. Nga ana tjetër, eksportet e pajisjeve dhe makinerive shënuan rritje në bazë vjetore. Importet e mallrave në këta dy muaj shënuan rënie vjetore prej 1%. Në përputhje me arritjet e eksporteve, importi më i ulët i komponentit të lëndës së parë të disa prej kapaciteteve eksportuese nga sektori i automobilave ka ndikim më të madh në uljen vjetore të importit. Kontribut më

⁴⁹Sipas Metodologjisë për shkëmbim të jashtëm tregtar, të dhënat për eksportin e mallrave publikohen në bazën f.o.b, dhe për importin e mallrave në bazën - c.i.f.

të vogël kanë pasur edhe importet më të ulëta të derivateve të naftës, krahasuar me importet e pajisjeve dhe makinerive, të cilat kanë shënuar rritje të vogël.



Sipas analizës së importit të mallrave nga aspekti i ndarjes sipas Sistemit të Llogarive Kombëtare (System of national accounts – SNA), vihet re një rritje e importit të mallrave të konsumit të gjerë, import pak më i lartë i mallrave kapitale, ndërsa tek importi i mallrave të ndërmjetme vijon rënia e vërejtur në disa tremujorë radhazi. Në këtë tremujor, importet e destinuara për konsum personal⁵⁰ vijnë të rriten në përputhje me dinamikën e rritjes së konsumit të amvisërive, ku kontributin më të lartë në rritje vijnë ta japin importet e mallrave të konsumit të paspecifikuara diku tjetër, si dhe importet e ushqimeve dhe pijeve (të përpunuara) kryesisht për përdorim në amvisëri.




Analiza e shkëmbimit të jashtëm tregtar sipas partnerëve tregtarë tregon se edhe në tremujorin e tretë të vitit 2024 Bashkimi Evropian është partneri më i rëndësishëm tregtar i ekonomisë vendase, me pjesëmarrje prej 61,1% në totalin e tregtisë me jashtë. Analiza e anës së **eksportit** tregon se rënia vjetore e reflekton kryesisht reduktimin e eksporteve të produkteve të ndryshme të industrisë kimike në Gjermani. Gjithashtu, në rënie kanë kontribuar edhe eksportet më të ulëta të automjeteve në Belgjikë, ndërsa kanë pësuar rënie edhe eksportet e hekurit dhe çelikut në Kinë dhe të lëndëve djegëse në Kosovë. Në të njëjtën kohë, këto arritje u zbutën nga rritja e eksporteve të lëndëve djegëse në Serbi dhe Bullgari, por dhe eksporti i xeheve në Bullgari gjithashtu është rritur. Kontributi pozitiv i arritjeve në pjesën tjetër të industrisë shpjegohet më së shumti me rritjen e eksportit të pajisjeve elektrike në Republikën Çeke, rritjen e eksportit të duhanit në Greqi, si dhe rritjen e eksportit


⁵⁰ Importet e mallrave për konsum personal analizohen si importe të destinuara për konsum personal, të përafëruara përmes importeve të mallrave për konsum të gjerë dhe importeve të vlerësuar të automjeteve për përdorim individual.

të automjeteve në SHBA. Analiza e kahut të **importit** tregon se kontributin më të madh në rënien e importeve e ka importi më i ulët i disa kategorive të produkteve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por kryesisht metalet e çmuara dhe produktet qeramike, si dhe importet më të dobëta të lëndëve djegëse nga Greqia. Rënia e importeve të metaleve të çmuara është arsyeja e uljes së importeve edhe nga Belgjika, por janë ulur dhe importet e lëndëve djegëse nga Rusia. Nga ana tjetër, kërkesa për importe për hekur dhe çelik nga Turqia, si dhe rritja e importeve të lëndëve djegëse nga Bullgaria kontribuan në rritjen e komponentit të importit. Për sa i përket **balanceve** të tregtisë së jashtme sipas partnerëve të veçantë, kontribut të lartë individual në përkeqësimin e deficitit tregtar në bazë vjetore ka suficiti më i ulët në shkëmbimin me Gjermaninë.


Eksporti i mallrave, sipas vendeve, në tremujorin e dytë të vitit 2024




Importi i mallrave, sipas vendeve, në tremujorin e parë të vitit 2024




Eksporti sipas partnerëve kryesorë tregtar dhe sipas produkteve, kontribut në gjithsej eksportin (në p.p.)



Importi sipas partnerëve kryesorë tregtar dhe sipas produkteve, kontribut në gjithsej importin (në p.p.)




Për sa i përket treguesve të konkurrencës së çmimeve, në tremujorin e tretë të vitit 2024, kursi real efektiv i këmbimit i deflatuar nga kostoja e jetesës regjistroi zhvlerësim prej 1.4% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i deflatuar nga kostot e prodhuesve të produkteve industriale shënoi ngritje të vlerës prej 2.7%. Arritjet e tilla janë reflektim i kostove relative të jetës, të cilat shënuan rënie prej 2.3%, dhe i çmimeve relative të prodhuesve të produkteve industriale, të cilët shënuan rritje prej 1.7% në bazë vjetore. Indeksi i kursit nominal efektiv të këmbimit ka rritje të vlerës me 1% në bazë vjetore, kryesisht si pasojë e zhvlerësimit të lirës turke ndaj monedhës vendase.




1.6.2. Llogaria financiare

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, llogaria financiare në bilancin e pagesave regjistroi dalje neto prej 276.3 milionë euro, ose 1.9% e PBB-së. Kështu, arrijtet në llogarinë financiare janë rezultat i daljeve neto të kredive dhe paradhënieve tregtare, si pasojë e rënies së detyrimeve të krijuara në bazë të operacioneve të tregtisë së jashtme në sektorin privat, si dhe e daljeve neto në kategorinë "valuta dhe depozita". Përveç kësaj, në këtë tremujor, dalje neto janë regjistruar edhe

në investimet e portofolit, si rezultat i shlyerjes së detyrimeve në bazë të letrave me vlerë⁵¹ të borxhit të emetuara më parë, si dhe te huamarrjet. Nga ana tjetër, flukse të konsiderueshme hyrëse neto janë realizuar në investimet e drejtpërdrejta, kryesisht si rezultat i hyrjeve në komponentin e borxhit.




Analiza në bazë vjetore tregon për arritje më të mira të flukseve financiare në tremujorin e tretë të vitit 2024, ku janë realizuar flukse më të ulëta neto krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kështu, kontributin më të madh në këto arritje e dhanë flukset më të ulëta dalëse neto në investimet e portofolit, si pasojë e shlyerjeve më të ulëta për letrat me vlerë të borxhit të emetuara më parë në tremujorin aktual krahasuar me tremujorin e tretë të një viti më parë. Njëkohësisht, flukse më të larta hyrëse neto janë regjistruar në investimet e drejtpërdrejta, gjë që i detyrohet tërësisht hyrjeve të larta neto në komponentin e borxhit krahasuar me daljet neto në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të njëjtin drejtim kanë vepruar edhe flukset më të ulëta dalëse neto në kategorinë "valuta dhe depozita", kryesisht për shkak të arritjeve të sektorit bankar. Nga ana tjetër, te kreditë dhe paradhëniet tregtare janë realizuar dalje neto, krahasuar me flukset hyrëse neto të realizuara vitin e kaluar. Në të njëjtin drejtim kanë vepruar edhe daljet neto te huamarrjet, kryesisht si pasojë e arritjeve te huamarrjet afatshkurtra, krahasuar me flukset e vogla hyrëse neto në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 arriti në 4,406.6 milionë euro, që paraqet rritje prej 69.1 milionë euro krahasuar me tremujorin e mëparshëm. E analizuar përmes faktorëve të ndryshimit, rritja e rezervave valutore rezulton nga ndërhyrjet e Bankës Popullore në tregun valutor.


⁵¹Më datë 30.09.2024 është shlyer kësti i dytë i kredisë për letrat me vlerë të regjistruar NSV (Namensschuldverschreibungen), në vlerë prej 69.9 milionë euro.



Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 arriti në 5,019 milionë euro, që paraqet rritje prej 612.4 milionë euro krahasuar me tremujorin e mëparshëm. E analizuar nëpërmjet faktorëve të ndryshimit, rritja e rezervave valutore në këtë tremujor vjen në masë të madhe nga transaksionet për llogari të qeverisë, si dhe nga ndërhyrjet në tregun valutor⁵².

1.6.3. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm bruto

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare të ekonomisë maqedonase është negativ dhe arrin në 8.544,4 milionë euro, ose 59% të PBB-së⁵³. Krahasuar me situatën në fund të tremujorit të mëparshëm, pozicioni neto i borxhit u ngushtua me 0.6 p.p. të PBB-së⁵⁴, e cila vjen si pasojë e rritjes më të madhe të mjeteve ndërkombëtare (me 0.9 p.p. të PBB-së), krahasuar me rritjen e detyrimeve ndërkombëtare (me 0.2 p.p. të PBB-së). Nga aspekti i sektorëve, ndryshimi tremujor rezulton nga rritja e mjeteve neto të bankës qendrore (rritje e mjeteve në bazë të letrave me vlerë të borxhit), si dhe nga rënia e detyrimeve neto të institucioneve depozituese dhe të qeverisë.




⁵²Më datë 17.10.2024 arriti kredia nga Hungarian Export Import Bank PLC në vlerë prej 500 milionë euro.


⁵³Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (që nga tetori i vitit 2024), e cila nuk i pasqyron rishikimet në rritje të PBB-së të bëra nga ESHS-ja për vitet 2022 dhe 2023.

⁵⁴Në vlera absolute, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë maqedonase në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi rënie tremujore prej 91.9 milionë euro.

Në bazë vjetore vihet re zgjerim i pozicionit negativ të investimeve ndërkombëtare me 3.6 p.p. të PBB-së⁵⁵, në kushtet e rritjes më të lartë të detyrimeve ndërkombëtare sesa rritjes së mjeteve ndërkombëtare (përkatësisht me 9.7 p.p. dhe 6.2 p.p. të PBB-së⁵⁶). Analiza sipas sektorëve tregon se ky ndryshim vjen kryesisht si pasojë e rritjes së detyrimeve neto të sektorëve të tjerë (rezultat i detyrimeve më të larta në bazë të investimeve të drejtpërdrejta), si dhe e pozicionit neto të qeverisë (detyrime më të larta në bazë të huave afatgjata). Nga ana tjetër, rritja e mjeteve neto të bankës qendrore ka kontribuar në ngushtimin e pozicionit të borxhit neto.




Burimi: BPRMV.




Burimi: BPRMV.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, gjendja e borxhit të jashtëm bruto arrin në 11,856.7 milionë euro, ose 81.9% të PBB-së, që paraqet rënie prej 0.2 p.p. të PBB-së, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. *Duke e përjashtuar efektin e aktiviteteve specifike për administrimin e rezervave valutore të Bankës Popullore⁵⁷, borxhi i jashtëm bruto arrin në 79.2% të PBB-së dhe shënon rritje tremujore prej 0.5 p.p. të PBB-së⁵⁸*, në kushtet e rritjes së borxhit privat (me 1.3 p.p. të PBB-së) dhe rënies së borxhit publik (me 0.8 p.p. të PBB-së). Rritja e borxhit privat rrjedh nga borxhi më i lartë ndërkombëtar, ndërsa rënia tremujore e borxhit publik në masë të madhe vjen si pasojë e rënies së huamarrjes së jashtme të qeverisë (bazuar në letrat me vlerë të borxhit dhe huamarrjet afatgjata⁵⁹), si dhe nga borxhi më i ulët i ndërmarrjeve publike.



*Pa transaksionet repo.
Burimi: BPRMV.



*Pa transaksionet repo.
Burimi: BPRMV.

Borxhi i jashtëm bruto në fund të tremujorit të tretë shënoi rritje vjetore prej 6.3 p.p. të PBB-së⁶⁰, në kushtet e rritjes më të lartë të borxhit privat sesa borxhi publik (përkatësisht me 3.8 p.p. dhe 2.5

⁵⁵Në vlera absolute, pozicioni neto i borxhit të ekonomisë maqedonase në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi rritje vjetore prej 461.4 milionë euro.

⁵⁶Në vlera absolute, në tremujorin e katërt të vitit 2024, mjetet ndërkombëtare shënuan rritje vjetore prej 839.1 milionë euro, ndërsa detyrimet ndërkombëtare shënuan rritje vjetore me 1,300.4 milionë euro.


⁵⁷Veprimtaritë specifike për administrimin e rezervave valutore të bankës qendrore u referohen marrëveshjeve-repo dhe operacioneve të tjera që lidhen me administrimin e rezervave valutore.

⁵⁸Në vlera absolute, borxhi i jashtëm bruto i ekonomisë maqedonase në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi rritje tremujore prej 70,3 milionë euro.


⁵⁹Më datë 30.09.2024 është shlyer kësti i dytë i kredisë për letrat me vlerë të regjistruara NSV (Namensschuldverschreibungen), në vlerë prej 69.9 milionë euro.

⁶⁰Në vlera absolute, borxhi i jashtëm bruto i ekonomisë maqedonase në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënoi rritje vjetore prej 834,6 milionë euro.

p.p. të PBB-së⁶¹). Rritja vjetore e borxhit privat është reflektim i rritjes së borxhit ndërkompani midis subjekteve të lidhura me kapitalin dhe detyrimeve më të larta të sektorit jobankar mbi bazën e kredive tregtare afatshkurtra. Ndryshimi i borxhit publik vjen si pasojë e rritjes së detyrimeve të qeverisë qendrore në bazë të huamarrjeve afatgjata⁶² dhe në një masë më të vogël nga borxhit më i lartë i ndërmarrjeve publike dhe i bankave publike.



Më 30 shtator të vitit 2024, borxhi i jashtëm neto arriti në 4,228.4 milionë euro ose 29.2% të PBB-së, duke përfaqësuar rënie tremujore prej 0.2 p.p. të PBB-së, i nxitur nga rënia e borxhit publik neto (me 1.0 p.p. të PBB-së), me rritje të njëkohshme të borxhit privat neto (me 0.8 p.p. të PBB-së).



Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së brendshme janë në zonën e sigurt. Përveç treguesit të pjesëmarrjes së borxhit të jashtëm bruto në PBB, i cili vazhdon të jetë në zonën e borxhit të lartë, të gjithë treguesit e tjerë të aftësisë paguese dhe likuiditetit tregojnë për borxh të ulët të ekonomisë vendase. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë strukturore në borxhin e jashtëm bruto të detyrimeve të bazuara në investimet e drejtpërdrejta si formë e financimit të kompanive me kapital të huaj, si dhe detyrimet nga kreditë tregtare, që janë instrument financimi në tregtinë ndërkombëtare, e zbut profilin e rrezikut në lidhje me pozicionin e borxhit të ekonomisë. Konkretisht, niveli i borxhit të jashtëm bruto pa kreditë tregtare dhe borxhin ndërkompani është më i ulët dhe arrin në 46.2% të PBB-së⁶³, që është tregues për borxh të moderuar.

⁶¹Në vlera absolute, borxhi i jashtëm publik dhe privat në tremujorin e tretë të vitit 2024 shënuan rritje vjetore përkatësisht me 329.6 dhe 505 milionë euro.

⁶² Në periudhën nga fillimi i tremujorit të katërt të vitit 2023, janë realizuar flukse hyrëse të konsiderueshme në bazë të huave të mëposhtme: 93.8 milionë euro nga Banka Botërore, 90 milionë euro nga Banka kreditore për rindërtim (KfW), Gjermani, 50 milionë euro nga OPEC, 150 milionë euro në bazë të kështit të dytë të linjës së Kredisë për kujdes dhe likuiditetit (PLL) dhe 50 milionë euro nga Komisioni Evropian.

⁶³Bëhet fjalë për borxhin pa marrëveshje-repo.



Treguesit për borxhin e jashtëm	Aftësia paguese				Likuiditeti		
	Pagesat e interesit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe flukse të tjera hyrëse	Borxhi bruto/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe flukse të tjera hyrëse	Borxhi bruto/PBB	Servisimi i borxhit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe flukse të tjera hyrëse	Rezervat devizore/ Borxhi afatshkurtër	Rezervat devizore/ Borxhi afatshkurtër, me maturim të mbetur**	Borxhi afatshkurtër/ Borxhi i përgjithshëm
	në %				pjesëmarrje	pjesëmarrje	në %
31.12.2010	3.22	140.4	59.7	13.9	1.49	0.99	27.9
31.12.2011	3.12	148.4	64.6	16.8	1.78	1.18	25.2
31.12.2012	2.92	142.1	67.6	13.1	1.64	1.03	26.7
31.12.2013	2.51	137.3	67.3	15.8	1.64	1.08	23.3
31.12.2014	3.0	149.1	74.0	17.2	1.8	1.1	22.3
31.12.2015	2.7	143.9	73.2	20.0	1.7	1.1	21.3
31.12.2016	2.4	149.4	79.3	14.9	1.7	1.2	21.9
31.03.2017	2.7	138.7	76.6	12.7	1.5	1.0	23.5
30.06.2017	2.7	140.7	77.7	12.7	1.3	0.9	24.2
30.09.2017	2.7	138.2	76.4	12.7	1.3	0.9	24.6
31.12.2017	2.7	139.2	76.9	12.7	1.3	0.9	23.9
31.03.2018	2.2	132.8	78.3	15.8	1.3	0.9	25.1
30.06.2018	2.2	135.5	79.9	15.8	1.3	1.0	25.6
30.09.2018	2.2	136.0	80.1	15.8	1.3	1.0	25.6
31.12.2018	2.2	131.4	77.4	15.8	1.4	1.0	25.8
31.03.2019	2.1	119.5	74.4	8.9	1.4	1.0	25.8
30.06.2019	2.1	121.5	75.6	8.9	1.4	1.0	26.4
30.09.2019	2.1	124.4	77.4	8.9	1.4	1.0	27.6
31.12.2019	2.1	123.2	76.6	8.9	1.6	1.0	25.5
31.03.2020	2.5	121.8	73.9	16.8	1.4	1.0	26.6
30.06.2020	2.5	121.8	73.9	16.8	1.4	1.0	26.6
30.09.2020	1.9	129.9	80.7	13.6	1.7	1.0	22.9
31.12.2020	1.9	122.3	77.9	13.6	1.9	1.1	20.4
31.03.2021	2.2	127.3	83.9	16.3	1.9	1.2	21.5
30.06.2021	2.2	130.0	85.6	16.3	1.9	1.2	22.0
30.09.2021	2.2	125.6	82.8	16.3	1.8	1.3	22.2
31.12.2021	2.2	126.6	83.4	16.3	1.8	1.3	21.5
31.03.2022	1.8	118.0	82.6	9.4	1.3	1.0	26.0
30.06.2022	1.8	117.3	82.1	9.4	1.2	0.9	26.3
30.09.2022	1.8	123.6	86.6	9.4	1.3	0.9	26.9
31.12.2022	1.8	123.4	86.4	9.4	1.5	1.0	24.7
31.03.2023	2.4	112.6	81.8	14.8	1.6	1.0	23.6
30.06.2023	2.4	114.5	83.3	14.8	1.6	1.0	23.8
30.09.2023	2.4	110.6	80.4	14.8	1.5	1.0	24.4
31.12.2023	2.4	114.4	83.1	14.8	1.8	1.2	22.7
31.03.2024	2.9	109.0	79.7	13.1	1.6	1.0	23.3
30.06.2024	2.9	110.5	80.8	13.1	1.6	1.0	24.0
30.09.2024	2.9	111.2	81.3	13.1	1.6	1.0	24.2
Kriteri i moderuar i borxhit*	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1.00		

*Kriteri i borxhit të moderuar është sipas metodologjisë së Bankës Botërore për llogaritjen e treguesve të borxhit, që nënkupton përdorimin e mesatareve lëvizëse 3-vjeçare të PBB-së dhe eksporteve të mallrave dhe shërbimeve si emërues në llogaritjen e treguesve.

E përgaditur në pajtim me "External debt statistics: Guide for compilers and users", e publikuar nga FMN-ja.

Burimi: BPRMV.



II. Politika monetare⁶⁴

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, Banka Popullore vazhdoi me normalizimin gradual të pozicionimit të politikës monetare në përputhje me kushtet ekonomike, duke e ulur me 0.25 p.p. normën bazë të interesit në muajt tetor dhe dhjetor, duke e reduktuar atë në nivelin 5.55%, ose rënie kumulative prej 0.75 p.p., duke filluar nga shtatori i këtij viti. Normat e interesit të instrumenteve të tjera monetare u ulën në muajin dhjetor me nga 0.25 p.p., me çka normat e interesit të depozitave njëditore dhe shtatë ditore u ulën në 3.95% dhe 4%. Sa i përket

⁶⁴Informacione më të detajuara për masat e reja monetare mund të gjenden në faqen e internetit të Bankës Popullore: https://www.nbrm.mk/content/MPI%20publikacii/03%202024%20Hronologija_na_promenite_vo_postavenosta_na_monetarnite_instrumenti_na_Narodnata%20banka.pdf

instrumenteve makroprudenciale, Banka Popullore vendosi që ta ruajë normën e shtresës mbrojtëse anticiklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 1,75% edhe në tremujorin e parë të vitit 2026. Me këto ndryshime ruhet qasja e kujdesshme në drejtimin e politikës monetare dhe pritet që niveli i normave të interesit, së bashku me ndryshimet e deritanishme në rezervën e detyrueshme dhe masat makroprudenciale të ndërmarra, të kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në afat të mesëm dhe në stabilitetin e kursit të denarit në raport me euron. Në tremujorin e katërt të vitit 2024, Banka Qendrore Evropiane e uli normën bazë të interesit për depozitat e disponueshme me 0.25 p.p. në tetor dhe dhjetor dhe e reduktoi atë në nivelin 3%. Rezervat valutore janë ruajtur në nivel të përshtatshëm dhe në zonën e sigurt, ndërsa baza e depozitave dhe kreditimi i bankave kanë shënuar normë të qëndrueshme rritjeje vjetore. Megjithatë, rreziqet që lidhen me mjedisin e jashtëm vazhdojnë të ekzistojnë, ndërkohë që po monitorohen me kujdes edhe rreziqet e mundshme nga faktorë të brendshëm që mund të ndikojnë mbi kërkesën dhe çmimet në periudhën në vijim. Banka Popullore do të vazhdojë të monitorojë me kujdes rreziqet në ekonominë vendase dhe atë globale dhe, nëse është e nevojshme, do të veprojë duke i përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, për ta ruajtur stabilitetin e kursit të këmbimit dhe stabilitetin e çmimeve.


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, Banka Popullore e uli normën bazë të interesit për depozitat dy herë me nga 0.25 p.p. , përkatësisht në tetor dhe dhjetor, duke e ulur atë në nivelin 5.55%. Normat e interesit për depozitat e disponueshme njëditore dhe shtatë ditore janë ulur me nga 0.25 p.p. në dhjetor dhe janë përkatësisht 3.95% dhe 4%. Shuma e ofruar e bonove të thesarit mbeti e pandryshuar në 10.000 milionë denarë dhe vazhdoi aplikimi i ndryshimeve të deritanishme në instrumentin e rezervës së detyruar. Me ndryshime të tilla ruhet matura në politikën monetare, duke i marrë parasysh rreziqet që lidhen me mjedisin e jashtëm që ekzistojnë ende, por edhe me faktorët e brendshëm që ndikojnë në kërkesën agregate. Edhe më tej pritet që niveli i normave të interesit, së bashku me ndryshimet e deritanishme në rezervën e detyrueshme dhe masat makroprudenciale të ndërmarra, të kontribuojnë në stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm dhe në ruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit ndaj euros. Në instrumentet makroprudenciale, Banka Popullore këtë tremujor miratoi vendim për vazhdimin e aplikimit të normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 1,75% edhe në tremujorin e parë të vitit 2026.



Vendimet gjatë kësaj periudhe u bazuan në arritjet⁶⁵ e treguesve bazë makroekonomikë në ekonominë vendase, dhe në radhë të parë në vlerësimet e inflacionit, i cili mbeti brenda pritshmërive, si dhe në lëvizjet e favorshme në tregun valutor. Konkretisht, norma vjetore e inflacionit u përshpejtua siç

⁶⁵I referohet informacionit të disponueshëm gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, i cili është marrë parasysh gjatë marrjes së vendimeve për pozicionimin monetar në atë periudhë.



pritej në muajt tetor dhe nëntor, si pasojë e rënies së bazës krahasuese nga fundi i vitit të kaluar te çmimet e ushqimeve. Në përputhje me pritshmëritë ishin edhe lëvizjet në inflacionin bazë si dhe rënia e mëtejshme e çmimeve në komponentin e energjisë, ku u vlerësua se mesatarisht për të gjithë vitin 2024, inflacioni do të jetë brenda normës së parashikuar. Afër projeksioneve ishte edhe përshpejtimi i rritjes ekonomike në tremujorin e tretë të vitit 2024, mes rishikimeve në rritje të të dhënave për gjashtëmujorin e parë të vitit. Nuk janë vërejtur ndryshime përsa i përket rreziqeve për rritjen në periudhën në vijim, të lidhura kryesisht me zhvillimet në mjedisin e jashtëm, si dhe me zbatimin e projekteve të infrastrukturës së brendshme. Situata në tregun valutor u vlerësua si e qëndrueshme, me lëvizje të favorshme në tregun valutor dhe ndërhyrje me blerje neto të devizave nga Banka Popullore, që kanë vazhduar që nga fillimi i vitit, gjë që mundëson ruajtjen e nivelit të duhur të rezervave devizore. Në të njëjtën kohë, flukset e depozitave dhe kredive kanë qenë më të mira se sa pritej për tremujorin e fundit të vitit.



Duke marrë parasysh strategjinë monetare të aplikuar, gjatë marrjes së vendimeve monetare merret parasysh përcaktimi i politikës së Bankës Qendrore Evropiane (BQE), e cila gjatë tremujorit të katërt e uli dy herë normën bazë të interesit për depozitat e disponueshme me nga 0.25 p.p., duke e reduktuar atë në nivelin 3%. Në të njëjtën kohë, BQE-ja e uli normën e interesit për operacionet kryesore të rifinancimit me të njëjtën shumë, duke e çuar atë në 3.15%. Kështu, diferenca ndërmjet normës bazë të interesit të Bankës Popullore dhe normës bazë të interesit të BQE-së për depozitat e disponueshme në dhjetor të vitit 2024 ishte 2.55 p.p. dhe mbeti e njëjtë si në tremujorin e kaluar. Në lidhje me normat treguese të interesit të tregut prej 1 m SKIBOR dhe 1 m EURIBOR, diferenca ndërmjet tyre u rrit me 0.5 p.p. në fund të muajit dhjetor të vitit 2024, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.



Sa i përket normave të interesit të depozitave në ekonominë vendase, në nëntor të vitit 2024, normat e interesit për depozitat në denarë dhe në valutë shënuan një rritje të lehtë për 0,1 p.p., krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndërkohë që në të njëjtin proporcion u rrit edhe diferenca e interesit, e cila arriti në nivelin 1 p.p. Në totalin e depozitave të reja të pranuar⁶⁶, diferenca e normës së interesit në nëntor u rrit lehtë në krahasim me fundin e tremujorit të mëparshëm dhe arriti në 0,9 pikë përqindjeje, në kushtet e rritjes së normave të interesit në denarë (nga 3,0% në shtator në 3,2% në nëntor) dhe rritjes së normave të interesit në valutë (nga 2,1% në shtator në 2,3% në nëntor).

⁶⁶Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e reja të miratuara rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.




2.1. Likuiditeti i bankave

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, likuiditeti në denarë i bankave ka shënuar rritje, e cila në tërësi vjen si pasojë e ndryshimeve të faktorëve autonomë, ndërkohë që instrumentet monetare kontribuuan në tërheqjen e likuiditetit.



Nga aspekti i ndryshimit të instrumenteve monetare, investimet e bankave në depozita të disponueshme (brenda natës dhe shtatë ditore) janë rritur për 10,328 milionë denarë në tremujorin e katërt të vitit 2024, që ka kontribuar në tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar. Në të njëjtën kohë, depozitat njëditore dhe shtatë ditore janë rritur përkatësisht me 6,640 dhe 3,688 milionë denarë. Gjendja e instrumentit bazë - bonove të thesarit të BPRMV-së mbeti e pandryshuar dhe në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 ishte 10.000 milionë denarë.

Faktorët autonomë në bazë neto në tremujorin e katërt të vitit 2024 kontribuuan në krijimin e likuiditetit të sistemit bankar për 12,247 milionë denarë. Një ndryshim i tillë i faktorëve autonomë vjen më së shumti nga ndërhyrjet në valutë dhe transaksionet e qeverisë, ndërkohë që paraja e gatshme në qarkullim ka kontribuar në uljen e likuiditetit.





Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, bankat në llogaritë e tyre në Bankën Popullore vazhduan të kenë më shumë mjete të ndara sesa shuma e përcaktuar e rezervës së detyruar në denarë, mesatarisht për rreth 1,0%.

III. Lëvizjet e tregjeve financiare

Norma e interesit në tregun e depozitave ndërbankare në tremujorin e katërt të vitit 2024 ishte mesatarisht 3.3%, në kushtet e rritjes së aktivitetit në këtë treg. Kuotimet mesatare të SKIBOR -it shënuan lëvizje të lehtë në rënie. Në tregun primar të letrave shtetërore me vlerë, emetimet e reja ishin kryesisht me maturime më të gjata, ndërsa në tregun sekondar të letrave me vlerë tregtohej me bono thesari dhe obligacione shtetërore. Në Bursën maqedonase, qarkullimi i aksioneve është rritur për 2,5 herë në krahasim me tremujorin e mëparshëm, ndërsa vlera e MBI-10 ka shënuar rritje tremujore prej 16,2%. Në bursat rajonale, indekset shënuan rritje të përshpejtuar, mesatarisht prej 4.4% në bazë tremujore. Nga aspekti i tregjeve financiare ndërkombëtare, indekset e paqëndrueshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, përkatësisht indekset MOVE dhe VIX, në tremujorin e katërt të vitit 2024 shënuan ndryshim në rritje, gjë që tregon rritje të pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë së tregjeve kryesisht të lidhura me zgjedhjet në SHBA, tensionet e rritura gjeopolitike si dhe rënien e qeverisë në Gjermani. Shumica e diferencave ndërmjet rendimenteve të eurobondeve maqedonase dhe atyre gjermane shënuan ndryshime shumë të vogla rënëse në krahasim me tremujorin e mëparshëm.



3.1. Tregu ndërbankar me depozita të pasiguruara

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, norma mesatare e interesit në tregun e depozitave ndërbankare (NINB) ishte 3.3% dhe është ulur me 0.9 p.p. krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Tregtimi në tregun e depozitave ndërbankare në tremujorin e katërt të vitit 2024 arriti në 790 milionë denarë (80 milionë denarë në tremujorin e mëparshëm), si rezultat i transaksioneve të realizuara njëditore dhe shtatë ditore. Pothuajse të gjitha kuotimet mesatare të SKIBOR-it shënuan zhvendosje shumë të vogël në rënie, duke shkuar deri në 0.02 p.p. krahasuar me tremujorin e mëparshëm.


**MBKS, SKIBOR, MKDONIA dhe norma e interesit të bonove të thesarit në përqindje****Tregtimi me depozita qarkullim, në milionë denarë**

3.2. Tregu i letrave shtetërore me vlerë


Gjendja e letrave shtetërore të emetuara në tregun primar në tremujorin e katërt të vitit 2024 shënoi rritje për 10,620 milionë denarë ose 5,0% në bazë tremujore dhe arriti në 223,986 milionë denarë. Kështu, rritja tremujore është kryesisht te letrat me vlerë me afat më të gjatë maturimi, përkatësisht obligacionet shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare, trevjeçare dhe dyvjeçare (me rritje përkatësisht 5.470, 4.139 dhe 1.993 milionë denarë), ndërkohë që zvogëlohet gjendja e obligacioneve shtetërore dhjetëvjeçare (për 1.217 milionë denarë). Analizuar nga aspekti i strukturës së letrave shtetërore me vlerë, obligacionet shtetërore janë ende kategoria dominuese, me pjesëmarrje 79.7%. Gjithashtu, obligacionet shtetërore pesëmbëdhjetëvjeçare vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e maturitetit të letrave shtetërore me vlerë me 50.1% (pothuajse identike me tremujorin e mëparshëm), që është në përputhje me udhëzimet e strategjisë fiskale të Ministrisë së Financave për emetimin e obligacioneve shtetërore me afat më të gjatë maturimi, në mënyrë që të optimizohen pagesat e borxhit dhe të reduktohet rreziku i rifinancimit.⁶⁷ Nga aspekti i strukturës valutore, letrat shtetërore me vlerë në monedhë vendase pa klauzolë valutore vazhduan ta ruajnë pjesëmarrjen e tyre dominuese, duke përbërë 75.7% të totalit të letrave shtetërore me vlerë (74.5% në tremujorin e mëparshëm). Për sa i përket strukturës së pronësisë, bankat në këtë tremujor e kanë rritur lehtësisht pjesëmarrjen e tyre, nga 33.1% në 34.2%, për shkak të pakësimit të pjesëmarrjes së investitorëve të tjerë (65.8%). Ndër investitorët e tjerë, fondet pensionale vazhdojnë të jenë më të përfaqësuara (me pjesëmarrje prej 47.4%).

Letrat shtetërore me vlerë
(gjendja, në milionë denarë)**Struktura kohore e LShV**
(gjendja, në milionë denarë)

⁶⁷ Strategjia fiskale për vitet 2024-2029, Ministria e Financave, shtator 2024.



**Struktura e pronësisë së LShV**
(gjendja, në milionë denarë)

Burimi: Ministria e Financave



Struktura devizore e LShV
(gjendja, në milionë denarë)

Burimi: Ministria e Financave

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, normat e interesit për letrat me vlerë të qeverisë të emetuara pa klauzulë valutore, të përcaktuara nga Ministria e Financave, kanë mbetur të pandryshuara krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Ndryshimi i vetëm është vërejtur në letrat me vlerë trevjeçare të qeverisë me klauzulë valutore, të cilat janë riemetuar pas një periudhe më të gjatë, me normë mesatare interesi prej 3,55% (emetimi i fundit në tremujorin e katërt të vitit 2020 me normë mesatare interesi 0,9%). Në segmentin e letrave me vlerë të qeverisë pa klauzulë valutore, në tregun primar u emetuan bono thesari dymbëdhjetë mujore, obligacione shtetërore dyvjeçare, trevjeçare, pesëvjeçare dhe pesëmbëdhjetëvjeçare, me norma interesi përkatësisht 3,80%, 3,85%, 3,95%, 4,2% dhe 5,60%.

Normat e interesit në tregun primar të LShV pa klauzulë devizore
(mesatarja, në %)**LShV me klauzulë devizore**
(mesatarja, në %)

Burimi: Ministria e Financave


Kurba e normës së kthimit të LShV pa klauzulë devizore
(në %)**Kurba e normës së kthimit të LShV me klauzulë devizore**
(në %)

*Norma e interesit e arritur në ankandin e fundit brenda tremujorit


Afati kohor

Qarkullimi i letrave me vlerë në tregun sekondar në tremujorin e katërt të vitit 2024 arriti në 1,170 milionë denarë, si rezultat i tregimit të transaksioneve-repo me afat maturimi deri në shtatë ditë (me rendiment mesatar prej 4,4%), tregimit të obligacioneve shtetërore me afat të mbetur të maturimit prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet (me rendiment mesatar prej 5.9%) dhe tregimit të bonove thesari me afat të mbetur të maturimit deri në një muaj (me rendiment mesatar prej 4.2%). Ndryshime të tilla tregojnë rritje të koeficientit të likuiditetit⁶⁸, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

⁶⁸Koeficienti i likuiditetit të tregut sekondar e përfaqëson raportin ndërmjet qarkullimit mesatar ditor dhe gjendjes së letrave shtetërore me vlerë.




Në tregjet financiare të SHBA-së në tremujorin e katërt të vitit 2024, rendimentet e letrave me vlerë 10-vjeçare të qeverisë u rritën dhe rezultuan mesatarisht rreth 4.3% (4.0% në tremujorin e mëparshëm), ndërsa në eurozonë, rendimentet e letrave me vlerë 10-vjeçare të qeverisë u ulën lehtë dhe arritën mesatarisht 2.6% (2.7% në tremujorin e mëparshëm).




Shumica e rendimenteve të eurobondeve maqedonase⁶⁹ në tremujorin e katërt të vitit 2024 shënuan zhvendosje në rënie, me rënie pothuajse identike edhe të rendimenteve të obligacioneve të qeverisë gjermane. Përfundim bën eurobondi i emetuar në vitin 2018 me afat maturimi në janar të vitit 2025, shtrirja e të cilit në raport me bonot gjermane u rrit, që është lëvizje e zakonshme e tregut të obligacioneve pak para afatit të maturimit. Tek obligacionet e tjera maqedonase, shtrirjet ndaj obligacioneve gjermane në përgjithësi mbetën në nivelin e tremujorit të mëparshëm, të cilat mesatarisht ishin përkatësisht 2.4 p.p., 2.7 p.p. dhe 3.0 p.p.

⁶⁹Bëhet fjalë për eurobondet maqedonase të emetuara në janar të vitit 2018, qershor të vitit 2020, mars të vitit 2021 dhe në mars të vitit 2023. Eurobonet janë emetuar në vlerë nominale përkatësisht 500 milionë euro, 700 milionë euro, 700 milionë euro dhe 500 milionë euro, me afat maturimi përkatësisht 7, 6, 7 dhe 4 vjet dhe norma vjetore interesi përkatësisht 2,75%, 3,675. %, 1.625% dhe 6.96%.



3.3. Bursat


Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024, vlera e indeksit të bursës maqedonase MBI-10 u rrit për 16,2% (rritje prej 13,9% në tremujorin e mëparshëm) dhe arriti në 10.201 pikë indeksi. Qarkullimi i përgjithshëm i bursës shënoi rritje të fuqishme tremujore, me 2.5 herë (rritje prej 39.7% në tremujorin e mëparshëm), kryesisht si rezultat i rritjes së qarkullimit të aksioneve. Vlera e indeksit të obligacioneve (OMB) gjatë tremujorit shënoi ndryshim minimal në rritje krahasuar me tremujorin e mëparshëm dhe arriti në 124 pikë indeksi (123 pikë indeksi në fund të tremujorit të mëparshëm).



Në tremujorin e katërt të vitit 2024, indekset e tregut të bursave nga rajoni të analizuar mesatarisht, gjithashtu shënuan rritje të përshpejtuar tremujore, e cila arriti në 4.4% (rritje prej 2.9% në tremujorin e mëparshëm). Kështu, rritje shënuan të gjithë indekset rajonale, me përjashtim të atyre rumunë dhe polakë, të cilët shënuan rënie të lehtë. Gjithashtu, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, indekset e paqëndrueshmërisë së tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve, përkatësisht indekset MOVE dhe VIKS⁷⁰, në bazë ditore, shënuan rritje më të moderuar, përkatësisht indeksi MOVE u rrit mesatarisht

⁷⁰Indeksi MOVE ((Merrill Lynch Option Volatility Estimate) e tregon ndryshueshmërinë e prejardhur (ose të nënkuptuar) të tregjeve amerikane të letrave shtetërore me vlerë. Indeksi VIKS (Volatility Index) është ndërtuar mbi bazën e ndryshueshmërisë së

me 3% (pas rritjes prej 4% në tremujorin e mëparshëm), ndërsa indeksi VIKS u rrit mesatarisht me 2% (pas rritjes prej 20% në tremujorin e mëparshëm). Lëvizjet e të dy indekseve, shikuar së bashku, tregojnë për rritje të pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë në tregjet globale të kapitalit, ndonëse në mënyrë më të moderuar, e parë në mënyrë dinamike, kryesisht për shkak të ngjarjeve rreth zgjedhjeve të mbajtura në SHBA, tensioneve të rritura gjeopolitike, si dhe zhvillimeve politike në Gjermani.



IV. Agregatët monetarë dhe kreditorë

Në tremujorin e fundit të vitit, u vu re një përshpejtim i ndjeshëm i dinamikës së rritjes së agregatit më të gjerë monetar M4. Përshpejtimi është i zakonshëm për këtë periudhë të vitit, ndërsa oferta më e lartë monetare gjatë kësaj periudhe korrespondon me kushtet ekonomike dhe financiare në ekonomi. Krijimi i masës së re monetare vjen kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve monetare më likuide, ndërkohë që kontribut pozitiv kanë si depozitat afatshkurtra ashtu edhe ato afatgjata. Një strukturë e tillë e rritjes shpjegohet pjesërisht nga faktorët sezonalë, përkatësisht kërkesa më e lartë për para për qëllime transaksionesh përpara festave të Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve, e plotësuar edhe nga konsumi më i lartë. Kështu, trendet e favorshme të kursimeve në lidhje me afatin e maturimit dhe strukturën valutore vazhdojnë edhe në këtë tremujor, të nxitura edhe nga masat e Bankës Popullore për mbështetjen e denarizimit dhe kursimeve afatgjata. Në linjë me rritjen e bazës së depozitave të bankave, edhe tremujori i katërt ka shënuar rritje të fuqishme tremujore të kreditimit, të drejtuar kah të dy sektorët, me përshpejtim më të madh te ndërmarrjet. Rezultatet e fituara nga Anketa për aktivitetin kreditor (AAK) në tremujorin e katërt të vitit 2024 tregojnë për lehtësim të mëtejshëm neto të kushteve të kreditimit në të dy sektorët, më i fuqishëm tek amvisëritë dhe më i dobët te ndërmarrjet, me rritje neto të kërkesës për kredi, më e fuqishme te ndërmarrjet dhe më e dobët tek amvisëritë, krahasuar me anketën e tremujorit të mëparshëm.


4.1. Agregatë monetarë

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, **masa më e gjerë monetare M4 shënoi rritje më të ndjeshme tremujore prej 7.5%** (rritje 1.5% në tremujorin e tretë), e cila është tipike për këtë periudhë të vitit dhe pjesërisht e reflekton kërkesën më të lartë për para për qëllime transaksionesh përpara festave të Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve. Konkretisht, e parë nga ana strukturore, rritja tremujore


prejardhur të opsioneve në indeksin SiP 500. Investitorët i përdorin të dy indeksat si tregues të gjendjeve dhe pritshmërive në lidhje me paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare. Ecuria në rënie tek indeksat tregon ulje të paqëndrueshmërisë.

vjen nga kontributi pozitiv i të gjithë komponentëve të masës monetare, por me ndikimin më të madh të parave të depozituara (3,8 p.p.), e ndjekur nga kontributi i depozitave afatshkurtra (1,7 p.p.), i depozitave afatgjata (1,4 p.p.) dhe i parave të gatshme në qarkullim (0,7 p.p.). Ndryshimet në strukturën valutore vazhdojnë të tregojnë rritje më të fuqishme të depozitave në denarë (me paratë e depozitave) krahasuar me rritjen e depozitave në valutë (me kontribut përkatësisht 5,6 p.p. dhe 1,3 p.p.), kështu që pjesa e depozitave në valutë në M4 në fund të tremujorit të katërt shënoi 36,8% dhe është 1,5 p.p. më i ulët krahasuar me fundin e tremujorit të mëparshëm. Në bazë vjetore, agregati monetar M4 shënoi rritje prej 11.4% (8.6% në fund të tremujorit të tretë).

Para e gjerë M4, struktura
(ndryshimet tremujore, kontributi në pikë përqindje)



(ndryshimet vjetore, kontributi në pikë përqindje)




Burimi: BPRMV.

Totali i depozitave në sistemin financiar⁷¹ në tremujorin e katërt të vitit 2024 shënoi rritje të ndjeshme prej 7.5% në bazë tremujore (pas një rritjeje të moderuar prej 1.5% në tremujorin e tretë). Nga **aspekti i sektorëve**, depozitat e amvisërive kanë kontribut pozitiv prej 4.4 p.p., të ndjekura nga depozitat e ndërmarrjeve me kontribut prej 3.2 p.p., me kontribut të vogël negativ të sektorëve të tjerë (prej 0.1 p.p.) në totalin e depozitave. Analizuar nga **aspekti valutore**, pjesa më e madhe, ose rreth 80% e rritjes së totalit të depozitave vjen nga depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozitave), të cilat janë ndikuar nga faktorët sezonalë, si pagesat e parakohshme të pagave, pensione, transfertave sociale etj., para festave të Vitit të Ri, por edhe nga mbështetja e përforcuar kreditore e bankave. Nga aspekti i **afatit të maturimit**, depozitat afatshkurtra dhe ato afatgjata janë në rritje (me kontribut pothuajse të barabartë, përkatësisht 1.8 p.p. dhe 1.6 p.p.). **Në bazë vjetore**, rritja e totalit të depozitave në fund të tremujorit të katërt arriti në 11.4% (rritje prej 8.4% në fund të tremujorit të tretë).

⁷¹ Të dhënat u referohen depozitave të sektorit joshjetëror në banka dhe kursimore, mjetet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë në BPRMV dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në llogaritë në BPRMV. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

**Depozitat totale**


(kontributi në ndryshimin tremujor, në pikë përqindje)

**Depozitat totale**

	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshimet tremujore, në %												
Depozitat totale	-2.9	0.2	3.0	4.7	-1.0	4.6	0.7	4.7	-0.6	2.7	1.5	7.5
kontributi në ndryshimet tremujore të totalit të depozitave, në p.p.												
Para të depozituara	-2.8	0.7	1.9	2.5	-1.3	2.5	-0.5	3.9	-1.7	1.7	0.3	4.1
Depozitat në denarë	-1.0	-0.9	0.3	0.7	0.3	1.0	0.4	0.4	0.9	0.7	0.6	2.0
Depozitat në devizë	0.9	0.3	0.9	1.5	0.0	1.0	0.8	0.4	0.2	0.3	0.6	1.4
Depozitat afatshkurte	0.6	0.3	0.7	1.2	-0.2	0.4	0.4	-0.3	-0.1	0.0	-0.5	1.8
Depozitat afatgjate	-0.7	-0.9	0.4	1.0	0.5	1.7	0.8	1.1	1.2	1.0	1.7	1.6
Amvisëritë	-0.9	1.4	1.2	2.0	0.7	1.7	0.0	2.7	1.1	1.8	1.4	4.4
Ndërmarrjet	-2.2	-0.9	1.7	2.5	-1.7	2.5	0.8	2.0	-2.0	0.6	0.8	3.2
Institucionet e tjera	0.2	-0.3	0.1	0.1	-0.1	0.4	-0.1	0.0	0.3	0.3	-0.7	-0.1

Burimi: BPRMV.

(kontributi në ndryshimin vjetor, në pikë përqindje)



Burimi: BPRMV.

Rritja e **depozitave të amvisërive** u përshpejtua në tremujorin e katërt të vitit (rritje tremujore prej 6.6%, krahasuar me rritjen e moderuar prej 2.1% në tremujorin e tretë të vitit). Nga **aspekti valutor**, rritja tremujore në masë të madhe rrjedh nga kontributi pozitiv i depozitave në denarë (më së shumti në para të depozitave, por edhe në depozita me afat në denarë), me kontribut të vogël nga depozitat në valutë (kontribut prej përkatësisht 6,0 p.p. dhe 0,6 p.p.). Nga aspekti i **strukturës së afatit të maturimit**, rritja është mbështetur tërësisht nga depozitat afatgjata (me kontribut prej 2.4 p.p.), ndërsa depozitat afatshkurtra janë ulur (me kontribut negativ prej 0.3 p.p.), gjë që tregon për vazhdimin e tendencave të favorshme të kursimeve edhe në tremujorin e fundit të vitit. **Në bazë vjetore**, rritja e totalit të depozitave të amvisërive në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 arriti në 13.8% (11.2% në fund të tremujorit të tretë).

Depozitat e ndërmarrjeve⁷² në tremujorin e katërt të vitit 2024 shënuan rritje të ndjeshme prej 11.5% në bazë tremujore (rritje prej 2.7% në tremujorin e tretë). Nga aspekti i **strukturës valutore**, rritje më të theksuar shënuan depozitat në denarë (përfshirë paratë e depozitave), në kushte të rritjes më të moderuar të depozitave në valutë (me kontribute pozitive përkatësisht 7.4 p.p. dhe 4.1 p.p.). Nga **aspekti i afatit të maturimit**, një kontribut të rëndësishëm prej 6.5 p.p. kanë depozitat afatshkurtra, ndërkohë që depozitat afatgjata shënojnë kontribut të vogël pozitiv prej 0.5 p.p. **Në bazë vjetore**, depozitat e ndërmarrjeve në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 janë 9.2% më të larta (rritje prej 4.7% në fund të tremujorit të tretë).

⁷² Rritja e depozitave të ndërmarrjeve është pjesërisht e lidhur me miratimin e një kredie në një shumë më të madhe për një kompani nga sektori i energjetikës, e cila ka ndikuar edhe në nivelin e depozitave.



Household deposits

	2022				2023				2024			
	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
quarterly change, in %												
Total household deposits	-1.4	2.1	1.9	3.1	1.0	2.6	0.0	4.2	1.7	2.7	2.1	6.6
contribution to quarterly change of total deposits, in p.p.												
Deposit money	-1.8	1.1	0.7	2.5	-0.2	1.2	-1.1	3.1	0.0	1.3	0.4	4.6
Denar deposits	-1.4	-0.8	0.0	0.7	0.5	0.9	0.5	0.7	1.2	0.7	1.1	1.5
FX deposits	1.8	1.8	1.2	-0.1	0.8	0.4	0.6	0.4	0.5	0.8	0.7	0.6
Short-term deposits	0.9	1.3	0.7	-0.6	0.1	-0.5	-0.2	-0.9	0.2	0.2	-1.0	-0.3
Long-term deposits	-0.4	-0.3	0.5	1.2	1.1	1.8	1.3	2.0	1.5	1.3	2.8	2.4



Source: NBRNM.

Depozitat e ndërmarrjeve

	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshimet tremujore, në %												
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	-7.8	-3.2	6.3	9.3	-5.8	9.4	2.8	6.9	-6.7	2.1	2.7	11.5
kontributi në ndryshimet tremujore të totalit të depozitave, në p.p.												
Para të depozituara	-6.0	-0.4	4.7	3.2	-4.5	5.5	0.2	6.0	-6.0	2.1	2.3	4.6
Depozitat në denarë	-0.4	-0.2	1.1	0.5	0.6	1.4	0.8	0.4	0.3	0.3	0.2	2.9
Depozitat në devizë	-1.4	-2.6	0.4	5.7	-1.9	2.5	1.8	0.5	-0.9	-0.3	0.3	4.1
Depozitat afatshkurte	-0.6	-0.8	0.9	5.4	-1.1	2.2	2.2	1.2	-1.8	-1.1	0.6	6.5
Depozitat afatgjate	-1.1	-2.0	0.7	0.7	-0.2	1.7	0.4	-0.3	1.1	1.1	-0.2	0.5

Burimi: BPRMV.

Analiza e rendimenteve⁷³ të kursimeve të reja tregon se në muajin nëntor normat e interesit të depozitave të reja të pranuar⁷⁴ në denarë dhe valutë të amvisërive janë përkatësisht 2,9% dhe 2,3%, (përkatësisht 2,9% dhe 2,2% në shtator). Në këto kushte, shtrirja e interesit ndërmjet kursimeve të reja në denarë dhe në valutë të amvisërive është e pandryshuar në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe është 1.1 p.p. Te **sektori korporativ**, normat e interesit për depozitat e reja të pranuar në denarë dhe në valutë në nëntor ishin përkatësisht 2,5% dhe 2,3% (përkatësisht 2,3% dhe 1,8%, në shtator). Me këto lëvizje, shtrirja e interesit ndërmjet depozitave të reja të pranuar në denarë dhe valutë të ndërmarrjeve në fund të nëntorit u ngushtua dhe arriti në 0,2 p.p. Sa i përket totalit të depozitave të pranuar (në denarë dhe në valutë), normat e interesit për depozitat e ndërmarrjeve dhe të amvisërive në nëntor shënuan përkatësisht 2,7% dhe 2,1%, dhe janë më të larta krahasuar me shtatorin e vitit 2024 (përkatësisht 2,3% dhe 2,0%).



4.2. Aktiviteti kreditues

Aktiviteti kreditues i bankave në tremujorin e katërt të vitit shënoi gjithashtu rritje të fuqishme tremujore prej 5.4% (1.5% në tremujorin e tretë). Zhvillime të tilla janë gjithashtu në përputhje me informacionet e Anketës për aktivitetin kreditor të kryer në tremujorin e katërt të vitit 2024, e cila tregon për lehtësim neto të kushteve për miratimin e kredive dhe rritje neto të kërkesës për kredi. Shikuar sipas sektorëve, në tremujorin e fundit, lehtësimi neto i kushteve për kreditim ka qenë më i fuqishëm tek amvisëritë dhe më i moderuar te ndërmarrjet, krahasuar me anketën e tremujorit të mëparshëm. Nga ana tjetër, rritje më e fuqishme neto e kërkesës vërehet te ndërmarrjet, ndërkohë që është më e dobët

⁷³ Të dhënat për normat e interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme:

http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

⁷⁴ Për sa i përket normave të interesit të depozitave të reja të pranuar, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për depozitat e reja të pranuar rrjedh nga fakti se ato rezultojnë nga vëllimi i depozitave të reja të pranuar (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.


tek amvisëritë, krahasuar me anketën e mëparshme. Për tremujorin e parë të vitit 2025, bankat presin lehtësim të mëtejshëm neto të kushteve të kreditimit, më të theksuar tek amvisëritë, si dhe rritje të moderuar neto të kërkesës në të dy sektorët.

Totali i kredive në sektorin privat


	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
Ndryshimet tremujore, në %												
Totali i kredive në sektorin privat	2.6	2.7	1.1	2.6	0.0	2.6	0.5	1.9	1.0	2.9	1.5	5.4
kontributi në ndryshimet tremujore të totalin e kredive, në p.p.												
Kreditë në denarë	1.3	1.1	-0.2	1.2	-0.3	1.3	0.7	1.7	1.1	3.0	1.8	4.2
Kreditë në deviza	1.3	1.6	1.4	1.4	0.4	1.3	-0.3	0.2	-0.1	-0.1	-0.3	1.2
Kreditë afatshkurte	1.4	0.5	-0.1	0.5	-0.5	0.1	-0.5	0.1	0.5	0.0	0.0	1.4
Kreditë afatgjate	1.3	2.0	1.2	2.5	0.6	2.5	1.0	1.8	0.2	2.8	1.4	4.1
Amvisëritë	0.8	1.3	0.8	0.7	0.6	1.1	0.7	0.9	0.7	1.3	1.1	1.4
Ndërmarrjet	1.8	1.3	0.3	1.9	-0.6	1.5	-0.3	1.0	0.3	1.7	0.5	3.9

Burimi: BPRMV.

kushtet për miratimin e kredive



kërkesa për kredi




Burimi: Anketa për aktivitetin kreditor, BPRMV-së.

Analiza e strukturës sektoriale të totalit të kredive të sektorit privat tregon për rritje të fuqishme tremujore të kredive për ndërmarrjet dhe amvisëritë, më të theksuar në sektorin e korporatave⁷⁵, që përbën 3.9 p.p. të rritjes së totalit të kredive në këtë tremujor. Nga **aspekti valutor dhe afati i maturimit**, dominon kontributi i kredive në denarë (4,2 p.p.) përkatësisht i kredive afatgjata (4,1 p.p.). **Pjesëmarrja e pretendimeve të dyshimta dhe të kontestuara**⁷⁶ në totalin e kredive është ulur në 2.6% (2.9% në tremujorin e mëparshëm).

⁷⁵ Rritja e kredive të ndërmarrjeve është pjesërisht e lidhur me miratimin e një kredie në një shumë më të madhe për një ndërmarrje publike nga sektori i energjetikës.

⁷⁶ Nga fillimi i vitit 2024, zbatohet Vendimi i ri për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të kreditimit i shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 57/23, me të cilin kryhet harmonizimi i mëtejshëm me kërkesat rregullatore të zbatueshme në Bashkimin Evropian dhe forcohet stabiliteti i sistemit bankar. Ai parashikon mënyrë të re të përcaktimit të ekspozimeve kreditore jofunkionale, i forcon kriteret për monitorim dhe kontroll të cilësisë së portofolit të kredisë së bankave dhe i përmirëson rregullat për ristrukturimin e ekspozimeve kreditore të bankave. Ndryshimet e reja metodologjike për përcaktimin e kredive jofunkionale mund të çojë në rritjen e tyre, të paktën në periudhën fillestare pas zbatimit të Vendimit, që është më shumë efekt i qasjes së ndryshme në përcaktimin e statusit jofunksional (në numërimin e ditëve të vonësës), sesa e ndryshimit të aftësisë kreditore të klientëve.

**Pjesëmarrja e kredive të dyshimta dhe kontestuese në totalin e kredive (në %)**

* I referohet pjesës së pjesëmarrjes së kredive të dyshimta dhe kontestuese në totalin e kredive të secilit sektor përkatës.
Burimi: BPRMV.


Në bazë vjetore, totali i kredive në tremujorin e katërt të vitit 2024 është më i lartë me 11.2% (7.5% në fund të tremujorit të tretë). Në kushtet e rritjes së fuqishme të depozitave, pjesëmarrja e totalit të kredive në totalin e depozitave u zvogëlua dhe arriti në 81.4% (83.1% në tremujorin e mëparshëm).

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, **kreditimi i sektorit "amvisëri"** shënoi rritje të moderuar tremujore prej 2.7% (ritje prej 2.0% në tremujorin e mëparshëm). Kështu, rritja edhe më tej më së shumti vjen nga kreditë për strehim dhe kreditë konsumatore, ndërkohë që kontributi i llojeve të tjera të kredive është negativ. Arritjet korrespondojnë me rezultatet e **Anketës për aktivitetin kreditues** të bankave për tremujorin e katërt të vitit 2024, të cilat tregojnë për lehtësim-neto të përmirësuar të kushteve të kreditimit dhe rritje të mëtejshme neto, ndonëse më të dobët, të kërkesës për kredi në sektorin "amvisëri". **Në aspektin valutor**, kontribut më të madh në rritje kanë kreditë në valutë, me kontribut mesatar pozitiv të kredive në denarë. E parë nga aspekti i **strukturës së afatit të maturimit**, rritja rrjedh tërësisht nga kreditë afatgjata, ndërkohë që reduktohen kreditë afatshkurtra. **Në bazë vjetore**, kreditë totale të amvisërive në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 janë më të larta me 8.8% (ritje prej 7.7% në fund të tremujorit të tretë).

Totali i kredive të amvisërive

	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
Ndryshimet tremujore, në %												
Totali i kredive të amvisërive	1.6	2.6	1.5	1.4	1.2	2.2	1.5	1.7	1.3	2.5	2.0	2.7
Kontributi në ndryshimet tremujore të totalin e kredive të amvisërive, në p.p.												
Kreditë në denarë	1.0	1.3	0.5	0.1	0.3	0.8	0.9	0.6	0.7	1.6	1.2	1.2
Kreditë në deviza	0.6	1.3	1.0	1.3	0.8	1.4	0.5	1.1	0.6	0.9	0.9	1.5
Kreditë afatshkurte	0.2	0.1	0.0	-0.2	0.2	0.0	0.3	-0.3	0.2	0.0	0.0	-0.3
Kreditë afatgjate	1.3	2.4	1.5	1.9	1.0	2.2	1.2	2.0	0.7	2.2	1.9	3.0

Burimi: BPRMV.





Në tremujorin e katërt të vitit 2024, shuma e **totalit të kredive të dhëna për sektorin e korporatave** shënoi rritje të fuqishme në bazë tremujore prej 8.2%, (rritje prej 1.0% në tremujorin e mëparshëm). Sipas rezultateve të **Anketës për aktivitetin kreditues** për tremujorin e katërt të vitit 2024, bankat tregojnë për rritje neto më të fuqishme të kërkesës për kredi totale nga ndërmarrjet, me lehtësim neto më të dobët të kushteve totale të kreditimit, krahasuar me anketën e mëparshme. Nga **aspekti valutor**, pjesa dominuese e rritjes vjen nga kreditë në valutën vendase. Sipas **strukturës së afatit të maturimit**, rritja është nxitur nga kreditë afatgjata, me kontribut të moderuar pozitiv të kredive afatshkurtra. **Në bazë vjetore**, kreditë totale të ndërmarrjeve në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 janë më të larta me 13.9% (7.5% në fund të tremujorit të mëparshëm).

Totali i kredive të ndërmarrjeve												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
Ndryshimet tremujore, në %												
Totali i kredive të ndërmarrjeve	3.7	2.8	0.7	3.9	-1.3	3.1	-0.6	2.1	0.7	3.5	1.0	8.2
Kontributi në ndryshimet tremujore të totalin e kredive të ndërmarrjeve, në p.p.												
Kreditë në denarë	1.7	0.9	-1.0	2.4	-1.1	2.0	0.5	2.9	1.5	4.6	2.6	7.5
Kreditë në deviza	2.0	1.8	1.8	1.5	-0.2	1.1	-1.1	-0.7	-0.8	-1.1	-1.6	0.7
Kreditë afatshkurte	2.7	0.9	-0.3	1.3	-1.4	0.3	-1.3	0.6	0.8	-0.1	0.2	3.3
Kreditë afatgjate	1.3	1.5	1.0	3.1	0.2	2.6	0.7	1.6	-0.3	3.5	1.0	5.3

Burimi: BPRMV.

Sipas të dhënave për normat e interesit⁷⁷ të kredive të reja të miratuara⁷⁸ në nëntor, normat e interesit për kreditë në denarë dhe në valutë për **amvisëritë** ishin përkatësisht 5,9% dhe 3,8% (përkatësisht 6,3% dhe 3,9%, në shtator). Në kushte të tilla, shtrirja e interesit ndërmjet kreditimit të ri në denarë dhe atij në valutë për amvisëritë u zvogëluar në 2,1 p.p. (2,4 p.p. në tremujorin e tretë). **Te ndërmarrjet**, normat e interesit për kreditë e reja të miratuara në denarë dhe në valutë janë përkatësisht 4,8% dhe 4,2% (përkatësisht 5,0% dhe 4,1%, në muajin shtator), kështu, shtrirja e interesit ndërmjet kreditimit të ri në denarë dhe atij në valutë të ndërmarrjeve u ul dhe arriti në 0,6 p.p. (0,9 p.p. në tremujorin e tretë). Në raport me **totalin e kredive** të miratuara për sektorin privat, në fund të muajit nëntor, normat e interesit për kreditë për amvisëritë dhe për ndërmarrjet ishin përkatësisht 5.7% dhe 5.1%, dhe janë të pandryshuara në të dy sektorët krahasuar me shtatorin e vitit 2024.




⁷⁷ Të dhënat për normat e interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori i vitit 2018. Më shumë informacion për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme: http://www.nbpm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nsp.

⁷⁸ Për sa i përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e reja të miratuara rrjedh nga fakti se ato rezultojnë nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

V. Financat publike


Në tremujorin e tretë të vitit 2024 është shënuar rritje e lartë vjetore e të hyrave buxhetore (prej 18%), si dhe rritje vjetore e shpenzimeve buxhetore (prej 13.1%). Megjithatë, rritja më e lartë e të ardhurave nga shpenzimet buxhetore ka kontribuar në uljen e deficitit buxhetor në bazë vjetore, i cili u zvogëluar në 0.1% të PBB-së (0.4% e PBB-së në të njëjtin tremujor të një viti më parë). Në periudhën janar-nëntor të vitit 2024, deficitit buxhetor arriti në 3.3% të PBB-së, ose 66.4% të deficitit të planifikuar për vitin 2024 sipas rialokimit të buxhetit. Deficiti buxhetor i realizuar në periudhën janar - nëntor të vitit 2024 është financuar përmes huamarrjes neto të shtetit, kryesisht në tregun e brendshëm, por edhe atë të jashtëm, duke i akumuluar njëkohësisht depozitat e shtetit në Bankën Popullore. Borxhi publik total në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 arriti në 61.1% të PBB-së dhe është relativisht i qëndrueshëm në bazë vjetore.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, **të hyrat e përgjithshme** në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁷⁹ shënuan rritje të lartë vjetore prej 18%, që paraqet përshpejtim në krahasim me rritjen e tremujorit të mëparshëm e cila ishte 15%. Në këtë rritje vjetore kontribuuan pothuajse të gjitha kategoritë e të hyrave buxhetore, me përjashtim të të hyrave jotatimore, të cilat shënuan rënie të vogël vjetore. Në kuadër të kategorive të veçanta, peshën më të rëndësishme në rritjen e të ardhurave totale e zënë tatimet, me kontribut prej 13.3 p.p. (10.2 p.p. në tremujorin e mëparshëm), si dhe të ardhurat nga kontributet me kontribut pozitiv prej 5.5 p.p. (4.8 p.p. në tremujorin e mëparshëm).




Rritja vjetore e **të ardhurave totale tatimore** në tremujorin e tretë të vitit 2024 u përshpejtua dhe arriti në 23.6%. Arritje të tilla rrjedhin nga kontributi më i lartë i të hyrave nga tatimet indirekte, më së shumti nga të hyrat e TVSH-së (me kontribut prej 16.4 p.p.), por në një masë më të vogël edhe nga akcozitat dhe taksat e importit (kontribute prej përkatësisht 3.2 p.p. dhe 1.4 p.p.). Gjithashtu, kontribut pozitiv në rritjen e të ardhurave tatimore kanë edhe tatimet e drejtpërdrejta, përkatësisht tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin (me kontribute përkatësisht 2,9 p.p. dhe 0,3 p.p.).

⁷⁹ Buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve.



Burimi: Ministria e Financave



Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV-së

Shpenzimet totale buxhetore të realizuara në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënuan rritje vjetore prej 13.1%, pas rënies në tremujorin e mëparshëm për shkak të shpenzimeve më të ulëta kapitale⁸⁰. E parë nga pikëpamja strukturore, rritja e totalit të shpenzimeve rezulton tërësisht nga rritja e shpenzimeve rrjedhëse, në kushtet e rënies së shpenzimeve kapitale⁸¹. Rritja vjetore e shpenzimeve rrjedhëse më së shumti vjen nga kategoria "transferta"⁸² (kontribut prej 12,9 p.p.), kurse kontribut më të moderuar ka edhe rritja në kategoritë "paga dhe kompensime" dhe "mallra dhe shërbime" (përkatësisht prej 2,8 p.p. dhe 1,5 p.p.), ndërsa kontribut negativ ka kategoria "pagesa të interesit" (0.8 p.p.)


⁸⁰Rënia e shpenzimeve kapitale në tremujorin e dytë është për shkak të bazës më të lartë të krahasimit nga tremujori i dytë i vitit 2023, kur është paguar një shumë e konsiderueshme për financimin e projektit për ndërtimin e infrastrukturës rrugore (korridoret 8 dhe 10-d).

⁸¹Shpenzimet rrjedhëse, përkatësisht transfertat, janë më të larta si rezultat i rritjes lineare të pensione në shtator për 2.500 denarë në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.


⁸²Kategoria "transferta" i referohet shpenzimeve për pensionet, shpenzimeve për mbrojtjen sociale, shpenzimeve për kujdesin shëndetësor dhe transfertave të tjera (kryesisht subvencione).

**Buxheti i RMV-së
(buxheti qëndror dhe i fondeve)**


Janar - Nëntor 2024



Burimi: Ministria e Financave dhe përllogaritjet e BPRMV-së

**Financimi i bilancit buxhetor
(në milionë denarë)**

(të dhënat vjetore, në milionë denarë)



■ Ndryshimi i depozitave*
■ Financimi i jashtëm, neto
■ Financimi i brendshëm, neto
■ Të hyra e tjera
■ Bilanci buxhetor
■ Bilanci buxhetor (% në PBB-së), sh.d.

* Ndryshimi pozitiv - tërheqja e depozitave; ndryshim negativ - akumulimi i depozitave.
Burimi: Ministria e Financave

Deficiti buxhetor në tremujorin e tretë të vitit 2024 ishte 1,291 milionë denarë, ose 0,1% e PBB-së⁸³, që paraqet arritje më të ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (deficit prej 0,4% të PBB-së). Deficiti i arritur në tremujorin e tretë ishte financiar kryesisht nëpërmjet huamarrjes neto të shtetit në tregun e brendshëm dhe tërheqjes minimale të mjeteve nga depozitat e shtetit në Bankën Popullore, gjatë shlyerjes neto të borxhit në tregun e jashtëm.

BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (Buxheti qëndror dhe buxheti i fondeve)

	2024							2024							
	Buxheti 2024	Rebalansi i buxhetit 2024	Reallocation 2024	Tr.1	Tr.2	Tr.2	Jan.-Nën. 2024	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Jan.-Nën. 2024	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Jan.-Nën. 2024
								Ndryshimi vjetor, në %	Kontributi në ndryshimin vjetor, në p.p.	Ndryshimi vjetor, në %	Kontributi në ndryshimin vjetor, në p.p.	Ndryshimi vjetor, në %	Kontributi në ndryshimin vjetor, në p.p.	Ndryshimi vjetor, në %	Kontributi në ndryshimin vjetor, në p.p.
TË HYRAT TOTALE	310,128	318,150	318,151	69,418	74,880	78,272	277,082	5.2	5.2	15.0	15.0	18.0	18.0	11.5	11.5
Të hyrat tatimore dhe kontributet	279,044	284,469	284,469	63,672	70,282	72,739	256,743	12.4	10.6	16.2	15.0	20.8	18.9	14.6	13.2
Tatimet*	178,067	179,257	179,257	39,761	43,997	46,231	161,955	10.8	5.9	17.8	10.2	23.6	13.3	14.7	8.4
Kontributet	100,977	105,212	105,212	23,911	26,285	26,508	94,788	15.2	4.8	13.6	4.8	16.1	5.5	14.4	4.8
Të hyrat jotatimore	20,394	22,541	22,541	4,957	3,843	3,757	15,959	26.9	1.6	1.5	0.1	-15.7	-1.1	6.4	0.4
Të hyrat kapitale	3,210	3,240	3,240	199	149	1,148	1,671	3.1	0.0	-17.2	0.0	11.9	0.2	-16.5	-0.1
Donacionet e huaja	7,479	7,900	7,900	590	606	628	2,709	-88.8	-7.1	-12.2	-0.1	2.6	0.0	-63.4	-1.9
SHPENZIMET TOTALE	343,638	362,816	362,816	84,086	84,068	79,563	306,738	20.9	20.9	-1.3	-1.3	13.1	13.1	10.8	10.8
Shpenzimet rrjedhëse	298,459	318,118	325,443	77,077	78,153	75,141	285,319	20.0	18.5	13.9	11.2	16.5	15.1	16.4	14.6
Shpenzimet kapitale	45,179	44,698	37,374	7,009	5,915	4,422	21,419	31.6	2.4	-64.4	-12.5	-23.8	-2.0	-32.9	-3.8
DEFICITI/ SUFICITI BUXHETOR	-33,510	-44,666	-44,666	-14,668	-9,188	-1,291	-29,656								
Financimi	33,510	44,666	44,666	14,668	9,188	1,291	29,656								
Të hyrat	78,564	83,727	83,727	9,339	14,212	10,280	67,532								
Të hyrat e tjera	0	500	500	253	43	457	930								
Kreditë e huaja	43,164	48,487	48,486	9,939	3,530	287	44,937								
Depozita	-4,863	-20,388	-20,387	-2,134	3,225	5	-33,846								
Bonot e thesarit të BPRMV-së	40,263	55,128	55,128	25,071	7,414	9,531	55,511								
Shitja e aksioneve	0	0	0	0	0	0	0								
Të dalurat	45,054	39,061	39,061	18,461	5,024	8,989	37,876								
Shlyerja e kryeqesë	45,054	39,061	39,061	18,461	5,024	8,989	37,876								
Borxhi i jashtëm	26,429	20,334	20,334	6,610	3,402	6,586	19,990								
Borxhi i brendshëm	18,625	18,727	18,727	11,851	1,622	2,403	17,886								
Të dalurat e tjera	0	0	0	0	0	0	0								


* Përfshinë edhe të hyrat tatimore (SSP)
Burimi: Ministria e Financave dhe përllogaritjet e BPRMV-së

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2024, të ardhurat totale buxhetore janë më të larta me 11.5% në bazë vjetore. Kjo kryesisht rrjedh nga arritjet më të mira tek të hyrat dhe kontributet tatimore, si dhe nga të hyrat jotatimore, ndërsa të hyrat nga donacionet e huaja⁸⁴ shënuan rënie më të madhe për shkak

⁸³Për llogaritjet përdoret shumica e parashikuar e PBB-së nominale (që nga tetori i vitit 2024), e cila nuk i pasqyron rishikimet në rritje të PBB-së të bëra nga ESHS-ja për vitet 2022 dhe 2023.

⁸⁴Në mars të vitit 2023, donacionet e huaja u rritën për shkak të grantit të marrë nga Bashkimi Evropian në vlerë prej 72 milionë eurosh për përbalimin e krizës energjetike.

të bazës më të lartë të krahasimit nga viti i kaluar. Në të njëjtën kohë, shpenzimet buxhetore janë më të larta për 10.8% në bazë vjetore, të cilat kontribuohen tërësisht nga shpenzimet rrjedhëse, me shpenzime kapitale më të ulëta⁸⁵. Në periudhën janar-nëntor të vitit 2024, deficitin buxhetor arriti në 29,656 milionë denarë ose 3,3% të PBB-së⁸⁶, që paraqet 66,4% të deficitit të planifikuar për vitin me rialokimin e Buxhetit⁸⁷ për vitin 2024. Deficiti i realizuar financohet në masë të madhe përmes huamarrjes neto në tregjet e brendshme dhe në tregun e jashtëm⁸⁸, duke i akumuluar njëkohësisht depozitat e shtetit në Bankën Popullore.



Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV-së

Gjendja e borxhit total publik⁸⁹ në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 është 61.1% e PBB-së⁹⁰, që paraqet rënie të lehtë prej 0.1 p.p. të PBB-së krahasuar me fundin e tremujorit të mëparshëm. Kjo është kryesisht për shkak të zvogëlimit të borxhit të jashtëm, me rritje të lehtë të borxhit të brendshëm. Nga aspekti i strukturës së borxhit, rënia vjen tërësisht si pasojë e rënies së borxhit të ndërmarrjeve publike (të garantuar dhe të pa garantuar)⁹¹ me 0.3 p.p. dhe arrin në 8.2% të PBB-së (8.5% e PBB-së në tremujorin e mëparshëm), me rritje të lehtë të borxhit total të qeverisë⁹² me 0.1 p.p. dhe arrin në 52.9% të PBB-së. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, borxhi publik total në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 është më i lartë me 6.0 p.p. të PBB-së.

⁸⁵Shpenzimet kapitale shënuan rënie si rezultat i bazës më të lartë të krahasimit nga viti 2023 për shkak të pagesave ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore (NPRRSH) për ndërtimin e autostradave të korridoreve 8 dhe 10-d.

⁸⁶Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (që nga tetori i vitit 2024), e cila nuk i pasqyron rishikimet në rritje të PBB-së të bëra nga ESHS-ja për vitet 2022 dhe 2023.

⁸⁷Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 250 e datës 11.12.2024.

⁸⁸Hyrja e kështit të dytë prej 155 milionë eurosh nga programi PLL (Linja për kujdes dhe likuiditet) i Fondit Monetar Ndërkombëtar në janar të vitit 2024 dhe hyrja prej 50 milionë eurosh nga huaja e Komisionit Evropian në maj të vitit 2024. Në mars të vitit 2024, shteti pagoi një kësht të maturuar prej rreth 70 milionë eurosh për obligacionin e njohur si "Namensschuldverschreibungen", përkatësisht NSV. Në tetor të vitit 2024 u realizua hyrja prej 500 milionë eurosh nga marrëveshja e huasë me Bankën Hungareze të Eksport-Importit PCL, Budapest (Hungarian Export Import-Bank PLC, Budapest).

⁸⁹Borxhi publik përcaktohet me Ligjin për borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19) sipas të cilit ai e përfaqëson shumën e borxhi shtetëror dhe të borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe nga shoqëritë tregtare që janë në tërësi ose kryesisht në pronësi të shtetit ose komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

⁹⁰Për llogaritjet përdoret shuma e parashikuar e PBB-së nominale (që nga tetori i vitit 2024), e cila nuk i pasqyron rishikimet në rritje të PBB-së të bëra nga ESHS-ja për vitet 2022 dhe 2023.

⁹¹Në përputhje me ndryshimet në Ligjin për borxhin publik nga maji i vitit 2019, borxhi i pa garantuar i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit llogaritet në borxhin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/ 05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe 98/19).

⁹²Borxhi shtetëror përkufizohet si shuma e borxheve të Qeverisë qendrore, fondeve publike dhe komunave.